

# Roli i shoqërisë civile për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm

Një Udhëzues për Evropën Juglindore



Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Vjenë, gusht 2018

© OSCE 2018

Dizajni dhe shtypja nga red hot n 'cool

Ilustrimet: © whitehouse/123rf; macrovector/123rf

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk do të riprodhohet, ruhet në një sistem apo transmetohet përmes mjeteve elektronike, mekanike, përmes fotokopjimit, regjistrimit apo mjeteve të tjera, pa miratimin paraprak me shkrim nga botuesit. Ky kufizim nuk do të jetë i vlefshëm për kopje digjitale apo të printuara të këtij botimi për përdorim të brendshëm brenda OSBE-së dhe për qëllime personale apo edukuese, për qëllime jofitimprurëse dhe jotregtare, me kusht që kopjet të njohin si burim të informacionit OSBE-në.

ISBN 978-3-903128-29-3

Departamenti i Kërcënimeve Ndërkombëtare

Sekretariati i OSBE-së

Wallnerstrasse 6, A-1010 Vjenë

Austri [www.osce.org/atu](http://www.osce.org/atu)

Botimi i këtij udhëzuesi u bë i mundur falë kontributeve bujare të qeverisë së Austrisë përmes Ministrisë Federale për Evropën, Integrimin dhe Punët e Jashtme. Përmbajtja e këtij botimi, duke përfshirë pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në të jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të këtyre donatorëve. Ky nuk është një dokument mbi bazë konsensusi. Sekretariati i OSBE-së nuk mban përgjegjësi për saktësinë apo plotësinë e çfarëdo lloj informacioni, për udhëzimet apo këshillat që ofrohen apo për gabime shtypi. Sekretariati i OSBE-së nuk mund të bëhet përgjegjës për humbje apo dëme që shkaktohen nga përdorimi i informacionit të këtij publikimi, si edhe nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen nga burime të jashtme, duke përfshirë edhe faqe interneti të jashtme të cilave iu referohet ky publikim.




Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë



Federal Ministry  
Republic of Austria  
Europe, Integration  
and Foreign Affairs

# Roli i shoqërisë civile

për parandalimin dhe luftimin  
e ekstremizmit të dhunshëm dhe  
radikalizimit që çon në terrorizëm  
Një Udhëzues për Evropën Juglindore





# Përmbajtja e lëndës

FALËNDERIME	4
SHKURTIME	5
FJALORTH	6
PARATHËNIE	8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
<b>1. HYRJE</b>	<b>10</b>
<b>2. KONCEPTET KRYESORE</b>	<b>17</b>
2.1 Çfarë është shoqëria civile?	17
2.2 Të kuptojmë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çon në në terrorizëm (VERLT)	18
2.3 Programet dhe strategjitë për parandalimin dhe luftën kundër VERLT	20
<b>3. ROLI I SHOQËRISË CIVILE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR VERLT</b>	<b>25</b>
3.1 Vlera e shtuar e shoqërisë civile	25
3.2 Aktorët kryesorë të shoqërisë civile për parandalimin dhe luftën kundër VERLT (P/CVERLT)	27
3.3 Aktorë të tjerë për P/CVERLT	32
<b>4. KONTEKSTI I EVROPËS JUGLINDORE</b>	<b>39</b>
<b>5. GARANTIMI I ROLIT EFEKTIV TË SHOQËRISË CIVILE NË P/CVERLT: UDHËZIME DHE PRAKTIKA TË MIRA</b>	<b>45</b>
5.1 Sfidat kryesore	46
5.2 Udhëzime dhe praktika të mira	50
<b>6. PËRFUNDIME</b>	<b>65</b>
BURIME TË PËRZGJEDHURA TË OSBE-SË	66
BIBLIOGRAFIA	68

# Falënderime

Ky udhëzues është përgatitur nga Departamenti i Kërcënimit Ndërkombëtar të OSBE-së (TNTD), Njësia e Masave kundër Terrorizmit (ATU), nën drejtimin e Georgia Holmer, Këshilltare e Lartë për Çështjet kundër terrorizmit.

ATU dëshiron të falënderojë Adrian Shtunin (Shtuni Consulting, LLC, Shtetet e Bashkuara të Amerikës) për kontributin e tij në përgatitjen e këtij udhëzuesi. Mbështetje e vyer është dhënë edhe nga drejtori i ATU-së, Argo Avakov dhe stafi Camilla Bognoe, Yuri Fenopetov, Agnieszka Hejduk, Orlaith King dhe Katerina Koçi.

ATU është mirënjohëse për bashkëpunimin dhe komentet e marra nga stafi i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Misioni në Bosnje Hercegovinë, Misioni në Kosovë, Misioni në Mal të Zi, Misioni në Serbi dhe Misioni në Shkup, si dhe subjekte të tjera të OSBE-së dhe institucione që kanë ofruar kontributin e tyre në përmirësimin e këtij Udhëzuesi.

ATU shpreh mirënjohje për ekspertët e angazhuar në rishikimin e plotë të këtij Udhëzuesi dhe sugjerimet e ofruara në Sesionin e Grupit të Punës së Ekspertëve për përgatitjen e këtij Udhëzuesi:

## **Veaceslav Balan**

Misioni i OSBE-së në Serbi

## **Elvira Hadzibegovic Bubanja**

Forumi MNE

## **Sejjaf Hadzic**

Grupi Këshillimor i të Rinjve i OSBE-së

## **Enri Hide**

Universiteti Evropian i Tiranës

## **Naim Hoxha**

Misioni i OSBE-së në Kosovë

## **Humera Khan**

Muflehun

## **Eric Manton**

Më parë me Misionin e OSBE-së në Shkup

## **Afrodita Musliu**

NEXUS – Koncepti Civil

## **Eric Rosand**

Projekti për parandalimin:

Organizimi Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

## **Edit Schläffer**

Gratë pa Kufij

## **Serkan Serin**

Misioni i OSBE-së në Shkup

## **Selma Zekovic**

Misioni i OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë

## **Susanna Naltakyan**

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

## **Lulzim Peci**

Instituti Kosovar për Kërkimet dhe Zhvillimet e Politikave

## **Valery Perry**

Misioni i OSBE-së në Serbi

## Akronimet dhe shkurtimet

<b>ATU</b>	Njësia e Masave kundër Terrorizmit
<b>BIH</b>	Bosnja dhe Hercegovina
<b>OShC</b>	Organizatata e Shoqërisë Civile
<b>CVE</b>	Lufta Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
<b>EU</b>	Bashkimi Evropian
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>ICCT</b>	Qendra Ndërkombëtare Kundër Terrorizmit
<b>ICAN</b>	Rrjeti Ndërkombëtar për Masat e Shoqërisë Civile
<b>OJQ</b>	Organizatata Joqeveritare
<b>ODIHR</b>	Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
<b>OSCE</b>	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>P/CVERLT</b>	Parandalimi dhe Lufta kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që çon në Ekstremizëm
<b>PVE</b>	Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm
<b>RUSI</b>	Instituti Mbretëror i Shërbimeve të Bashkuara
<b>TNTD</b>	Departamenti Kërcënimeve Transnacionale
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>UN Women</b>	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
<b>UNESCO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën
<b>VERLT</b>	Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizmi që çon në Terrorizëm

# Fjalorth

Në këtë Fjalorth qartësohen disa prej termave kryesore të përdorura në këtë udhëzues. Përkufizimet e dhëna në këtë fjalorth janë vetëm për qëllimet e këtij udhëzuesi dhe nuk përbëjnë përkufizime zyrtare të OSBE-së

**Komuniteti** – gratë, burrat, grupet shoqërore dhe institucionet që ndërveprojnë në fusha të njëjta dhe/ose kanë interesa të përbashkëta.

**Shoqëria civile** – grupime të ndryshme aktorësh, komunitetesh dhe formacionesh shoqërore, të regjistruara zyrtarisht ose jo, që përfaqësojnë një shumëllojshmëri rolesh dhe angazhimesh në jetën publike për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe objektivave të përbashkëta.

**Aktorët e shoqërisë civile** – përfaqësuesit kryesorë të komunitetit, ndërmjet të cilëve gratë, të rinjtë, udhëheqësit fetarë, që luajnë rol të rëndësishëm dhe kontribuojnë efektivisht për mirëqenien e shoqërisë.

**Policimi në komunitet** – përfaqëson një filozofi dhe një strategji organizative, e cila nxit partneritetin dhe përpjekjet për bashkëpunim ndërmjet policisë dhe publikut të gjerë, me qëllim identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen me efikasitet dhe me efektivitet të problemeve të kriminalitetit, frikës së krimit, çështjeve të sigurisë dhe sigurimit fizik, trazirave sociale dhe prishjes së marrëdhënieve të fqinjësisë për të përmirësuar cilësinë e jetës së të gjithë individëve

**Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm** – veprime bashkëvepruese për të luftuar përpjekjet e ekstremistëve të dhunshëm në radikalizimin, rekrutimin dhe angazhimin e ndjekësve të tyre në akte të dhunshme; si dhe, për të trajtuar faktorët specifikë që mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që çon në terrorizëm.

**Lufta kundër terrorizmit** – politikat, ligjet dhe strategjitë e aktorëve shtetërorë, të zbatuara kryesisht nga organet ligjzbatuese, agjencitë e shërbimeve të fshehta informative, apo agjencitë e mbrojtjes të cilat synojnë të zbulojnë komplotet terroriste dhe të godasin organizatat terroriste.

**Ish - ekstremistët e dhunshëm** – individë të shkëputur nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi që çojnë në terrorizëm, të cilët mund të luajnë rol të rëndësishëm për ndërgjegjësimin publik dhe praktikave të besueshme kundër terrorizmit.



**Qasje gjinore** – ndërgjegjësimi dhe shqyrtimi i nevojave, i përvojave dhe i statusit të diferencuar të grave dhe burrave bazuar në kontekstin shoqëror dhe kulturor.

**Programet e ndërhyrjes** – programet që adresohen ndaj grupimeve/individëve “në rrezik” dhe që synojnë parandalimin e veprimtarisë kriminale që çon në terrorizëm. Këto quhen programe “integrimi” ose “programe shkëputjeje”. Programet janë vullnetare dhe përfshijnë mekanizma referimi, mbështetje psiko-sociale, mentorim, debate teologjike/doktrinare, trajnim dhe mbështetje për arsim dhe punësim etj.

**Programet e parandalimit** – programet që synojnë të reduktojnë rrezikun për rekrutim/mbështetje ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe krijojnë rezistencë ndaj ndikimit dhe përhapjes së tij. Këto programe përfshijnë: ndërgjegjësimit mbi kërcënimet ndaj ekstremizmit të dhunshëm në shkolla, fushatat e informimit publik dhe diskutime në komunitete, dialogun ndërfaqor, rritjen e kapaciteteve për mësuesit dhe drejtuesit e komuniteteve në identifikimin dhe mbështetjen e personave të prekshëm ndaj radikalizimit, mesazhet e mediave, vendosjen e besimit të ndërsjelltë ndërmjet komuniteteve dhe organizatave ligjzbatuese, etj.

**Radikalizmi që çon në terrorizëm** – procesi dinamik, përmes të cilit një person pranon dhunën që çon në akte terroriste si një veprim të pranueshëm, e në raste të caktuara, të ligjshëm. Njihet si proces që mund ta shndërrojë një person për të advokuar dhe vepruar në mbështetje të terrorizmit ose për t’u angazhuar personalisht në akte terroriste.

**Programet rehabilituese** – programe që përqendrohen tek individët e dhunshëm të radikalizuar, në raste të caktuara edhe te familjet e tyre, në kontekst të nevojave dhe shkallës së radikalizimit të këtij personi. Llojet e programeve përfshijnë: programet e deradikalizimit/shkëputjes që zhvillohen në institucionet e privimit të lirisë; programet e kujdesit pas lirim, të cilat përqendrohen tek mundësitë reintegruese të ish të dënuarve për terrorizëm dhe programet për integrimin e luftëtarëve të huaj, të kthyer në vendin e origjinës. Disa programe ofrojnë trajnim arsimor dhe profesional, këshillim, mundësi punësimi, etj.

**Elasticiteti** – aftësia për të përballuar, reaguar dhe për t’u rimëkëmbur nga një gamë ngjarjesh të dëmshme dhe të padëshirueshme.

**Qasja e integruar e shoqërisë** – qasje që adreson parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, e mbështetur nga politikëbërësit dhe profesionistët, e cila parashikon rol të përcaktuar për çdo sektor dhe aktor të shoqërisë civile nëpërmjet ndërhyrjeve specifike dhe zbatimit të programeve të rehabilitimit, shkëputjes dhe deradikalizimit.

# Parathënie

Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi sot janë sfida komplekse, që nuk kufizohen vetëm te kufijtë. Grupet terroriste dhe lëvizjet e dhunshme ekstremiste paraqiten të shpërndara dhe kërcënimi bëhet më i vështirë për t'u identifikuar dhe parandaluar. Ne jemi dëshmitarë të sulmeve dhe të akteve të dhunshme të vetëfrymëzuara në disa prej shteteve anëtarë të OSBE-së. Disa terroristë janë luftëtarë të huaj, të tjerë paraqiten të lidhur ngushtë me komunitetet e tyre. Qëllimet, motivet dhe justifikimi ndaj dhunës janë të ndryshme, sikundër paraqiten idetë që mbështetin këta persona.

Ky realitet kërkon një përgjigje të plotë dhe të bashkërenduar ndërkombëtarisht. Shtetet anëtare të OSBE-së janë shprehur pa ekuivok kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, nëpërmjet një qasjeje shumëplanëshe me fokus parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që çon në Terrorizëm (VERLT).

Angazhimi i OSBE-së për parandalimin e VERLT reflekton kuptimin dhe ndërgjegjësimin e shtuar për masat që duhen marrë dhe përpjekjet efektive për parandalimin e terrorizmit. Investimi në kohë dhe burime bëhet për të kuptuar arsyet që çojnë persona të caktuar në vetëflim për një lëvizje ose kauzë të dhunshme ekstremiste si dhe për të trajtuar dhe zbutur problemet dhe pakënaqësitë që shtynë këta persona në këtë drejtim. Pavarësisht ndërgjegjësimit të politikëbërësve në zonën e OSBE-së mbi rëndësinë e parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm (P/CVERLT), ende nuk ka dialog, angazhim dhe bashkëpunim të mjaftueshëm me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë joqeveritarë në lidhje me konceptimin, zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve dhe politikave të rëndësishme që synojnë P/CVERLT.

Iniciativat e suksesshme të P/CVERLT bazohen në qasjen e integruar të shoqërisë, e cila shfrytëzon ndikimin dhe përpjekjet e shoqërisë civile, në veçanti të grave, të rinjve, mësuesve, udhëheqësve fetarë, dhe përfaqësuesve të komuniteteve. Ky udhëzues reflekton angazhimin e OSBE-së për të mbështetur rolin e rëndësishëm që luan shoqëria civile në parandalimin e VERLT, si dhe për

të vlerësuar dinamikat, ndjeshmëritë dhe sfidat e këtij roli. Ai ofron udhëzime praktike për politikëbërësit, dhe profesionistët e angazhuar nga shoqëria civile, që punojnë për t'i çuar përpara iniciativat e e shoqërisë civile në P/CVERLT.

Njësia e Masave kundër Terrorizmit (ATU) në Departamentin e Kërcënimeve Transnacionale të Sekretariatit të OSBE-së është një qendër burimore për 57 shtetet anëtare të OSBE-së, ndërhyrjet në terren dhe institucionet e pavarura; dhe ndihmon për të mbështetur dhe zbatuar angazhimet kundër terrorizmit të OSBE-së. Shpresojmë që ky udhëzues do të kontribuojë për garantimin e proceseve gjithëpërfshirëse, zhvillimin e programeve dhe strategjive P/CVERLT. Ne besojmë se çështjet e trajtuara në këtë udhëzues do të ndihmojnë për t'i dhënë trajtë të qartë diskutimeve dhe dialogut të qëndrueshëm.

Udhëzuesi ka në fokus rajonin e Evropës Juglindore. Në të nxirren në pah sfidat në rajon dhe reflektohen shembuj të praktikave të mira. Ky udhëzues do të replikohet më tej për vendet e Azisë Qendrore.

Ky udhëzues bën pjesë në Serinë e Udhëzuesve të planifikuar nga ATU për rajonin, dhe adreson sfidat për zhvillimin dhe zbatimin e programeve efektive të P/CVERLT. Ne jemi të bindur se ky udhëzues dhe të tjerë që do pasojnë do të shërbejnë si materiale burimore të vyera për politikëbërësit dhe profesionistët që punojnë për të garantuar paqen dhe sigurinë në të gjithë zonën e OSBE-së.



**Rasa Ostrauskaite**

Koordinatorë e Aktiviteteve për Adresimin e Kërcënimeve Transnacionale  
Sekretariati i OSBE-së

# Përmbledhje

Shoqëria civile përfaqëson grupime të ndryshme aktorësh, komunitetesh dhe formacionesh shoqërore, të regjistruara zyrtarisht ose jo, që përfaqësojnë një shumëllojshmëri rolesh dhe angazhimesh në jetën publike për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe objektivave të përbashkëta.

Shoqëria civile luan një rol vendimtar në “qasjen e integruar të shoqërisë” për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm (P/CVERLT). Aktorët e shoqërisë civile pozicionohen qartë dhe garantojnë besueshmëri dhe përvojë në ndërhyrjet komunitare me grupe të veçanta në identifikimin dhe adresimin e problemeve dhe pakënaqësive të individëve/grupeve më të prekshme ndaj ndikimit të grupeve ekstremiste të dhunshme.

Rinia, gratë dhe përfaqësuesit e komuniteteve janë aktorët kryesorë të shoqërisë civile në përpjekjet për P/CVERLT, për shkak të ndikimit dhe aftësisë së tyre për të nxitur ndryshime shoqërore. Grupe të tjera interesi, si mediat, autoritetet ligjzbatuese, mësuesit, studiuesit e përfaqësuesit e botës akademike, si dhe sektori privat mund të japin kontribute të rëndësishme në parandalimin e VERLT.

Grupet dhe aktorët e shoqërisë civile në Evropën Juglindore e më gjerë përballen me sfida të mëdha për përgatitjen dhe zbatimin e programeve me ndikim ndaj P/CVERLT, të tilla si: kufizimet politike, ligjore dhe institucionale; pjesëmarrja në hartimin e politikave dhe strategjive në nivel qeveritar; mbështetja dhe financimi i programeve të qëndrueshme; ngritja dhe konsolidimi i kapaciteteve të brendshme; garantimi i sigurisë personale; dhe krijimi i partneriteteve efektive me aktorët qeveritarë.

Disa hapa praktikë që ndihmojnë përkrahjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve produktive ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe organizatave të shoqërisë civile (OShC), synojnë në krijimin e mekanizmave të koordinimit me role dhe përgjegjësi të qarta dhe partneriteteve të qëndrueshme ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë.

Kapacitetet e OShC-ve mund të fuqizohen duke shkëmbyer praktikatat e mira për programet e P/CVERLT, duke identifikuar dhe mbështetur grupe më pak të njohura, por të besueshme, duke krijuar rrjete dhe platforma rajonale për bashkëpunim, dhe duke vënë në kontakt profesionistët me studiuesit dhe akademikët për rezultate të mbështetura në të dhëna praktike.





# 1. Hyrje

Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi janë, në thelb, mohimi i vlerave demokratike, si toleranca, respekti, gjithëpërfshirja dhe diversiteti, të cilat qëndrojnë në themel të punës së OSBE-së. Pavarësisht kërcënimeve dhe sulmeve të disa prej shteteve anëtarë të OSBE-së, evidentohet një qasje e unifikuar dhe angazhim i përbashkët, i 57 shteteve anëtare të OSBE-së për parandalimin dhe luftën kundër e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm (P/CVERLT). Ky angazhim përfshin njohjen e dakordësuar të “rolit të rëndësishëm që luan rinia, familja, gruaja, viktimat e terrorizmit, udhëheqësit fetarë e kulturorë, drejtuesit e strukturave arsimore dhe mësuesit, shoqëria civile dhe media për të kundërshtuar prirjet ekstremiste të individëve/grupeve të caktuara; për të adresuar faktorët që nxisin terrorizmin. Ky rol spikat në nxitjen dhe garantimin e respektit të ndërsjelltë, bashkëjetesën paqësore ndërmjet kulturave, duke promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, liritë themelore, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës”<sup>1</sup>.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile për P/CVERLT është në interesin më të lartë të qeverive për shkak se aktorët e shoqërisë civile pozicionohen qartë dhe garantojnë besueshmëri dhe përvojë në ndërhyrjet komunitare me grupe të veçanta në identifikimin dhe adresimin e problemeve dhe pakënaqësive të individëve/grupeve më të prekshme ndaj ndikimit të VERLT. Megjithatë, rëndësia e “qasjes së integruar të shoqërisë ” ndaj parandalimit të VERLT shpesh kuptohet më shumë në teori sesa në praktikë. Në shumë shtete terminologjia që lidhet me sigurinë dhe shkallën e përfshirjes së aktorëve joqeveritarë është në fillesa dhe, praktikisht, e patëstuar. Nevoja për partneritete të mirëfillta ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe shoqërisë civile është e kuptueshme por e vështirë të realizohet. Për të ndryshuar këtë realitet, qeveritë duhet të sigurojnë hapësirë dhe mbështetje për zhvillimin e organizatave dhe nismave në nivel lokal dhe duhet të përforcojnë mesazhin që qeveritë e njohin vlerën që ka roli i individëve, i komuniteteve dhe i shoqërisë civile për forcimin e sigurisë.

Në këtë mënyrë, ky udhëzues ndihmon dhe mbështet rolin që luan shoqëria civile për parandalimin dhe luftën kundër VERLT, në krijimin e besimit të ndërsjelltë ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe përgjegjësisë së përbashkët ndaj sigurisë. Udhëzuesi i adresohet **politikëbërësve** të angazhuar në hartimin e strategjive dhe planeve të veprimit për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin

1 OSBE MC.DOC/4/15 (4 dhjetor 2015)

e dhunshëm dhe radikalizmin që çon në terrorizëm. Në mënyrë të veçantë, udhëzuesi synon të garantojë rolin e shoqërisë civile ndaj P/CVERLT dhe të inkurajojë një proces gjithëpërfshirës gjatë hartimit të politikave dhe strategjive.

Ky udhëzues i adresohet **aktorëve të shoqërisë civile** – organizatave dhe individëve që angazhohen në parandalimin e VERLT. Ky udhëzues shërben për të prezantuar aktivitete që lidhen me P/CVERLT dhe për të orientuar iniciativa të reja, të sigurta dhe të qëndrueshme. Idetë dhe udhëzimet e paraqitura në këtë botim janë shkruar për të nxitur dialog dhe diskutime kritike lidhur me mënyrën se si mund të adresohen iniciativat e shoqërisë civile lidhur me P/CVERLT.

Ky udhëzues është përshtatur me shembuj dhe interpretime praktike nga ndërhyrjet dhe iniciativat e deritanishme të OSBE-së në terren, me rëndësi të veçantë për rajonin e Evropës Juglindore. Për këtë qëllim, ATU/TNTD ka mbledhur një grup aktorësh të shoqërisë civile, akademikë dhe ekspertë nga rajoni për të diskutuar mbi sfidat dhe praktikatat e mira në këtë kontekst. Shembujt e praktikave të mira nxjerrin në pah një pjesë të madhe të punës së rëndësishme që po kryhet në rajon.

Kreu në vijim, *seksioni 2*, shpjegon konceptet kryesore dhe terminologjinë përkatëse që lidhet me radikalizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Ky sesion merr ne shqyrtim gjithashtu, spektrin e politikave dhe ndërhyrjeve në fushën e P/CVERLT.

*Seksioni 3* shpjegon rëndësinë e qasjes së integruar të shoqërisë ndaj P/CVERLT dhe rolin që luajnë aktorët e shoqërisë civile për sigurinë. Në trajtim merren dhe grupet e tjera të interesit, përfshi policinë, mësuesit dhe mediat.

Evropa Juglindore shqyrtohet në veçanti në *seksionin 4*, ku përshkruhen sfidat aktuale dhe roli i shoqërisë civile.

*Seksioni 5* ofron udhëzime të qarta dhe praktike në lidhje me aktivitetet që mund të zbatohen nga aktorët e shoqërisë civile në kuadër të P/CVERLT. Theksi në këtë pjesë vihet te praktikatat e mira në rajon.

Ky udhëzues refekton ekspertizën dhe përvojën e gjerë të operacioneve të OSBE-së në terren në Evropën Juglindore; ai sjell në vëmendje botime të mëparshme të OSBE-së, si “Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm”: Qasja e policimit në komunitet. Burimet e përzgjedhura të OSBE-së dhe bibliografia ofrojnë referime të vlefshme për politika dhe programe që adresojnë P/CVERLT.







## 2. Koncepte kryesore

### 2.1 Çfarë është shoqëria civile?

Nëse do të kërkohej një përkufizim mbi shoqërinë civile, atëherë interpretimi do të orientohej më tepër në lidhje me komponentët që nuk përbëjnë shoqërinë civile si psh., “fushë jashtë familjes, tregut dhe shtetit”<sup>2,3</sup>; organizma “joqeveritare”, “jofitimprurëse” dhe “jotregtare”, sesa në lidhje me karakteristikat e organizatave të shoqërisë civile. Në përgjithësi, shoqëria civile kuptohet më mirë si “grupime të ndryshme aktorësh, komunitetesh dhe formacionesh shoqërore, të regjistruara zyrtarisht ose jo, që përfaqësojnë një shumëllojshmëri rolesh dhe angazhimesh në jetën publike për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe objektivave të përbashkëta”. Aktorët e shoqërisë civile zakonisht përfshijnë: udhëheqësit dhe grupet komunitare; shoqatat dhe entitetet vendore; udhëheqësit fetarë dhe organizatat fetare; grupet online dhe komunitetet e mediave sociale; organizatat joqeveritare ndërkombëtare, kombëtare dhe ato të angazhuara në terren (OJQ); sindikatat dhe shoqatat profesionale; fondacionet bamirëse dhe filantropike; institucionet akademike dhe kërkimore; dhe grupet artistike komunitare<sup>4</sup>.

Në varësi të kontekstit, familja dhe partitë politike mund të konsiderohen si pjesë e mozaikut të shoqërisë civile. Pavarësisht rolit advokues në orientimin e politikave, ligjeve dhe rregulloreve, shoqëria civile nuk kërkon të marrë kontrollin e shtetit. Kjo e bën specifik rolin e shoqërisë civile në krahasim me organizatat dhe partitë politike që konkurrojnë për të pasur kontrollin e pushtetit. Si rrjedhojë, partitë politike përgjithësisht nuk konsiderohen si pjesë e shoqërisë civile, edhe pse ndonjëherë ato konsiderohen si organizata hibride të

2 Report mbi aktivitete, korrik 2005 – gusht 2006 (Qendra për Shoqërinë Civile, Shkolla e Ekonomisë dhe Shkenca Politike, Londër)

3 Koncepti dhe përkufizimi i qëndrueshmërisë së shoqërisë civile (Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare, 2017)

4 Bashkimi Evropian në një botim të kohëve të fundit, *Programi shumëvjeçar indikativ për Programin Tematik “Organizatat e shoqërisë civile (OSHc) dhe autoritetet lokale për periudhën 2014-2020”* përfshin shtesën e mëposhtme të OSHc-ve: “Organizatata joqeveritare, organizatat që përfaqësojnë popujt indigjenë, organizatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare dhe/ose etnike, organizatat e diasporës, organizatat e migrantëve në klubet e vendeve partnere, shoqatat lokale të tregtarëve dhe grupet e qytetarëve, kooperativat, shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat (partnerët socialë), organizata që përfaqësojnë interesat ekonomike dhe sociale, organizatat që luftojnë kundër korrupsionit dhe mashtrimit dhe që promovojnë qeverisjen e mirë, organizatat e të drejtave civile dhe organizatat që luftojnë diskriminimin, organizatat lokale (duke përfshirë rrjetet) të përfshira në bashkëpunimin rajonal dhe integrimin e decentralizuar, organizatat e konsumatorëve, të grave dhe organizatat rinore, mjedisore, të mësimdhënies, kulturore, kërkimore dhe organizatat shkencore, universitetet, kishat dhe shoqatat dhe bashkësitë fetare, organizatat filozofike dhe jofetare, mediat dhe çdo shoqatë joqeveritare dhe fondacioni i pavarur”.

shoqërisë civile (OSHC)<sup>56</sup>. Po kështu, familjet dhe rrethi farefisnor përgjithësisht përjashtohen nga shoqëria civile, për shkak të lidhjes së gjakut ndërmjet anëtarëve të familjes<sup>7</sup>.

Shoqëria civile tradicionalisht ka pasur qasje të drejtpërdrejtë, fizike të ndërhyrjeve. Për shkak të ndikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), është evidentuar një formë e re e angazhimit qytetar, me impakt të gjerë në format e bashkëpunimit për arritjen e qëllimeve shoqërore. Deri në fund të vitit 2017, gjysma e popullsisë së botës, ose rreth 3,819 miliardë njerëz, vlerësohen si përdorues aktivë të internetit,<sup>8</sup> tre miliardë prej të cilëve vlerësohen si përdorues aktivë të mediave sociale. Ky revolucion teknologjik ka sjellë shtrirje gjeografike dhe shoqërore të komuniteteve të mediave sociale, me pjesëmarrje të personave nga vende të ndryshme të botës, kultura të ndryshme dhe realitete të ndryshme politike. Këto rrjete formale ose informale kanë aftësinë për t'u angazhuar me shpejtësi me publikun e gjerë duke tërhequr vëmendje ndaj shkaqeve (pozitive ose negative) që mund të kenë pasur ndikim shumë të kufizuar.

## 2.2 Të kuptojmë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që çon në terrorizëm (VERLT)

Ekzistojnë përkufizime dhe kuptime të ndryshme ligjore, politike dhe akademike të terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Këto përkufizime shërbejnë për qëllime të ndryshme dhe nuk janë gjithmonë të përafuara, gjë që ndonjëherë sfidon përpjekjet për t'i çuar përpara praktikatat e mira dhe për të ndërtuar bashkëpunimin ndërkombëtar. Në përgjithësi, **ekstremizmi i dhunshëm** i referohet akteve të dhunës që justifikohen ose shoqërohen me ideologji ekstreme fetare, shoqërore ose politike.

Në planin konceptual, ekstremizmi i dhunshëm zakonisht konsiderohet më i shtrirë dhe i nuancuar sesa terrorizmi<sup>9</sup>. Plani i Sekretarit të Përgjithshëm

5 Shoqëria civile globale: Po ndryshon botën? (Scholte, J.A., 1999) (Global Civil Society: Changing the world?).

6 Kryerja e një vlerësimi DG: Një kuadër për zhvillimin e strategjisë (USAID, 2000).

7 Megjithatë, disa teoricienë politikë e shohin familjen ose sferën e jetës së brendshme si një pjesë integrale të shoqërisë civile. Shihni *Gjirnia dhe Shoqëria Civile* (Jude Howell, GCS Knowledge Base, 2005).

8 Shih [www.statista.com](http://www.statista.com).

9 Shih rishikimin e literaturës kundër ekstremizmit të dhunshëm nga Nasser-Eddine, Garnham, Agostino dhe Caluya (2011); Ekstremizmi i dhunshëm nga Glazzard dhe Zeuthen (2016); CVERLT: Ide, rekomandime dhe praktika të mira nga rajoni i OSBE-së, Neumann (2017).

të Kombeve të Bashkuara për Masat për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm thekson se “ekstremizmi i dhunshëm manifestohet në forma të ndryshme, ekziston rreziku që dy termat mund të shkrihen me justifikimin e masave kundër terrorizmit, duke rrezikuar të përfshijë forma sjelljesh që duhen klasifikuar si akte terroriste<sup>10</sup>.” Terminologjia e lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin paraqet vështirësi të interpretimit gjuhësor dhe konceptual, veçanërisht nga perspektiva e të drejtave të njeriut<sup>11</sup>.

**Radikalizmi** i referohet procesit përmes së cilit një individ përkrah ose mbështet më shumë se një ide ekstremiste. Është një koncept me interpretime të ndryshme. Ndonjëherë ky term përdoret me kuptimin e një lidhje të nënkuptuar midis ideve radikale dhe dhunës. Këto interpretime janë problematike: jo gjithkush me ide radikale mund të përfshihet apo të mbështesë aktivitete të dhunshme; në fund të fundit, aftësia për të pasur ide, pavarësisht natyrës së tyre, mishërohet dhe mbrohet si një e drejtë themelore e njeriut<sup>12</sup>. Nën dritën e së drejtës së lirisë së shprehjes idetë radikale mund të përfshijnë ide “që fyejnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose një pjesë të caktuar të popullsisë”<sup>13</sup>. Por, idetë radikale mund të nxisin ndryshime të dobishme shoqërore. Lëvizjet për heqjen e skllavërisë apo përkrahësit e së drejtës për të zgjedhur në fillesat e tyre konsideroheshin ide radikale, për shkak të qëndrimit kundër normave mbizotëruese të kohës.

OSBE ka konsoliduar terminologji specifike për këto koncepte: **ekstremizëm i dhunshëm dhe radikalizëm që çon në terrorizëm (VERLT)**. “Radikalizmi që çon në terrorizëm” i referohet “procesit dinamik sipas të cilit një individ nis ta pranojë dhunën terroriste si një mënyrë të mundshme, ndofta edhe legjitime veprimi. Eventualisht, por jo domosdoshmërisht, kjo mund ta bëjë personin të flasë në favor, të veprojë në mbështetje apo edhe të përfshihet në akte terrorizmi.”<sup>14</sup>. Ky term thekson rëndësinë e dallimit ndërmjet veprimtarisë kriminale dhe të ligjshme.

10 Plani i veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, sesioni i shtatëdhjetë, A/A/70/674).

11 Raporti i Raportit të Posaçëm të OKB-së Dok./HRC/31/65 për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirisë themelore gjatë luftimit të terrorizmit.

12 E drejta për lirinë e mendimit dhe të shprehjes pa ndërhyrje mbrohet nga neni 19 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1948 dhe përforcohet nga neni 19 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1966.

13 GJEDNJ, *Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*, çështja nr. 5493/72, 7 dhjetor 1976.

14 Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm: qasja e policimit në komunitet (OSBE TTD dhe ODHR, 2014).

## 2.3 Programe dhe strategji për parandalimin dhe luftën kundër VERLT

**Parandalimi dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm (P/CVERLT)** i referohet një spektri politikash, programesh dhe ndërhyrjesh që synojnë parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të lidhur me radikalizmin terrorist. Sërish, kuadri i miratuar nga OSBE thekson lidhjen midis radikalizmit/ekstremizmit, akteve të dhunës dhe terrorizmit të parashikuar si vepër penale dhe, në mënyrë të qartë, thekson rëndësinë e mbrojtjes së lirive themelore kur angazhimi fokusohet drejt parandalimit të kërcënimeve ndaj sigurisë.

Për qëllimet e këtij udhëzuesi, P/CVERLT dallohet nga lufta kundër terrorizmit për faktin se kjo ndërhyrje nuk etiketon terroristët ose veprimtarinë terroriste në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes hetimeve, arrestimeve apo ndjekjes penale. P/CVERLT përqendrohet tek: (i) parandalimi dhe lufta ndaj proceseve të radikalizmit që mund të çojë në terrorizëm; (ii) trajtimi dhe ulja e problemeneve dhe pakënaqësive strukturore, shoqërore, ekonomike dhe politike që mund të favorizojnë ekstremizmin e dhunshëm; (iii) dhënien e ndihmës për ata që tashmë janë radikalizuar, me synim shkëputjen ose deradikalizmin dhe riintegrimin në shoqëri; dhe (iv) ndërtimin e komuniteteve rezistente ndaj VERLT. Nga ana tjetër, lufta kundër terrorizmit i referohet morisë së aktiviteteve të ndërmarrë kryesisht nga organet ligjzbatuese, agjencitë e zbulimit dhe ndonjëherë edhe agjencitë e mbrojtjes, “që synojnë pengimin e kompleteve terroriste dhe shpërbërjen e organizatave terroriste”<sup>15</sup>. Gjithashtu, ndërkohë që strategjitë P/CVERLT projektohen dhe drejtohen kryesisht nga autoritetet shtetërore, zbatimi i tyre nuk kufizohet vetëm tek aktorët qeveritarë por përfshin një spektër të gjerë aktorësh.

Terminologji të tjera të ngjashme ose të mbivendosura që përdoren nga bashkësia ndërkombëtare përfshijnë: lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm (CVE), parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm (PVE), dhe kundër-radikalizmi (CR). Një përkufizim i CVE përkufizon “veprime bashkërenduese të ekstremistëve të dhunshëm për të radikalizuar, rekrutuar dhe mobilizuar ndjekësit në kryerjen e veprimeve të dhunshme si dhe për të trajtuar faktorët specifikë që mundësojnë rekrutimin e ekstremistëve të dhunshëm në akte terroriste”<sup>16</sup>. PVE është shkurtimi i “parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm”, term i cili është mjaft i përhapur në OKB dhe organizmat brenda saj. Ky përkufizim merr në konsideratë

15 Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm: Ide, rekomandime dhe praktika të mira nga rajoni i OSBE-së (Neumann, OSBE 2017).

16 Departamenti i Shtetit dhe Strategjia e Përbashkët e USAID-it për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Departamenti Amerikan i Shtetit dhe USAID-i, 2016).

kushtet lehtësuese dhe shkaqet që çojnë në terrorizëm, si psh., qeverisja e dobët, struktura përjashtuese sociale dhe arsimi i papërshtatshëm<sup>17</sup>. Termi “kundër-radikalizëm” vë gjithashtu theksin te parandalimi: “kërkon të parandalojë radikalizimin e popullsisë rezistente”. Objektivi është që të krijohet aftësia përbaluese personale dhe komunitare kundër radikalizmit konjitiv (të sjelljes) dhe/ose të dhunshëm përmes një shumëllojshmërie mjetesesh joshtrënguese<sup>18</sup>. Me pak fjalë, këto terma përfshijnë përpjekje proaktive dhe parandaluese.

Spektri i aktiviteteve, programeve dhe llojeve të angazhimeve në fushën e P/CVERLT është i gjerë dhe përfshin përpjekje në nivel ndërkombëtar, rajonal, kombëtar, komunitar dhe personal<sup>19</sup>. Linjat specifike të përpjekjeve përcaktohen nga fushat prioritare të veprimit, të identifikuar në strategjitë qeveritare. Llojet e qasjeve dhe programeve ndikohen, ndër të tjera, nga natyra e kërcënimit, normat shoqërore dhe rrethanat politike, strukturat e qeverisjes, burimet, kapacitetet dhe traditat.

Dy mënyra të zakonshme për të kategorizuar programet e P/CVERLT janë sipas **llojit**: ndërgjegjësimi, trajnimet, komunikimet strategjike etj. ose sipas **funksionit**: parandalimi, ndërhyrja dhe rehabilitimi. Disa lloje programesh përfshijnë më shumë se një fushë funksionale. Disa ekspertë sugjerojnë se kuadret për reduktimin e dhunës nga grupet kriminale, ose modelet e shëndetit publik mund të jenë të dobishme për qëllimin e zhvillimit dhe grupimit të programeve të P/CVERLT-së<sup>20,21</sup>.

**Programet e parandalimit** – programet që synojnë të reduktojnë rrezikun për rekrutim/mbështetje ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe krijojnë rezistencë ndaj ndikimit dhe përhapjes së tij. Këto programe përfshijnë: ndërgjegjësim mbi kërcënimet ndaj ekstremizmit të dhunshëm në shkolla, fushatat e informimit publik dhe diskutime në komunitete, dialogun ndërfaqor, ngritjen e kapaciteteve për mësuesit dhe drejtuesit e komuniteteve në identifikimin dhe mbështetjen e personave të prekshëm ndaj radikalizimit, mesazhet e mediave, vendojen e besimit të ndërsjelltë ndërmjet komuniteteve dhe organizatave ligjzbatuese, etj.

17 Plani i veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Sesion i shtatëdhjetë A/A/70/674)

18 Parandalimi i Radikalizimit të Dhunshëm në Amerikë (Grupi i Gatishmërisë për Sigurinë Kombëtare, Qendra e Politikave Dypalëshe, 2011).

19 Inventarizimi: Mjetet analitike për të kuptuar dhe hartuar programet e P/CVE-së (Holmer dhe Bauman, USIP, gusht 2018).

20 Kanarinat në minierën e qymyrit: Dhuna ndërpersonale, dhuna e grupeve kriminale dhe ekstremizmi i dhunshëm përmes optikës parandaluese të shëndetit publik (Eisenman D.P., Flavahan L., 2017).

21 Praktika premtuese për angazhimin e të rinjve në paqe, siguri dhe P/CVE (USAID, PEPFAR, YouthPower).

**Programi i ndërhyrjes** synon të etiketojë audiencat “në rrezik” dhe kërkon të ndërhyjë në rrugën e radikalizimit të një personi përpara se ai të ketë kaluar vijën e veprimtarisë kriminale, apo akte dhune. Llojet e programeve që bien në këtë kategori ndonjëherë njihen si “integruese” ose “programet e daljes”. Këto programe janë vullnetare dhe përfshijnë: mekanizmat e referimit, mbështetje psiko-sociale, mentorim, debat teologjik/doktrinor, trajnim dhe mbështetje me arsim dhe punësim, etj.

**Programet rehabilituese** – programe që përqendrohen tek individët e dhunshëm të radikalizuar, në raste të caktuara edhe te familjet e tyre, në kontekst të nevojave dhe shkallës së radikalizimit të këtij personi. Llojet e programeve përfshijnë: programet e deradikalizimit/ shkëputjes që zhvillohen në institucionet e privimit të lirisë; programet e kujdesit pas lirimit, të cilat përqendrohen tek mundësitë reintegruese të ish të dënuarve për terrorizëm dhe programet për integrimin e luftëtarëve të huaj, të kthyer në vendin e origjinës. Disa programe ofrojnë trajnim arsimor dhe profesional, këshillim, mundësi punësimi, etj.

Politikat dhe programet e P/CVERLT të hartuara dhe zbatuara nga aktorët qeveritarë dhe shoqëria civile duhet të synojnë të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë ekstremizmin ultranacionalist dhe ekstremizmin e djathtë ekstrem, ose atë të majtë ekstrem. Po aq e rëndësishme është që këto programe të mbrojnë të drejtat e njeriut dhe të mos shkelin liritë civile, në veçanti, lirinë e mendimit dhe të shprehjes, lirisë së besimit, mos diskriminimin ndaj komuniteteve ose grupeve të caktuara. Këto të drejta rrezikohen gjatë përpjekjeve për të parandaluar VERLT, ndaj qeveritë duhet të kujdesen që çdo kufizim i cilësuar të jetë legjitim, i nevojshëm dhe proporcional<sup>22</sup>. Përveç sigurisë për të mos shkelur të drejtat e njeriut nga programet P/CVERLT, është e rëndësishme të kujtojmë se promovimi i të drejtave të njeriut është në vetvete një barrierë e fuqishme ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit<sup>23</sup>.

---

22 Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: qasja e policimit në komunitet (OSBE TTD dhe ODIHR, 2014).

23 Plani i veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Sesioni i shtatëdhjetë A/A/70/674).







# 3. Roli i shoqërisë civile për parandalimin dhe luftën kundër VERLT



## 3.1 Vlera e shtuar e shoqërisë civile

Ekziston një konsensus i gjerë ndërkombëtar, sipas të cilit, përcakton si të pamjaftueshme përpjekjet e deritanishme kundër terrorizmit, si dhe ato ndërhyrje për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm. Siç është theksuar edhe në Planin e Veprimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe dokumente të ndryshme strategjish dhe politikash nga organizata ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e sigurisë, mjetet tradicionale kundër terrorizmit shpesh synojnë të gjejnë simptomat, por jo faktorët shtytës të ekstremizmit të dhunshëm. Qeveritë kanë përgjegjësinë për të ofruar sigurinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe të mbështetin shtetin e së drejtës dhe zbatimin e politikave që luftojnë diskriminimin, marginalizimin dhe përjashtimin. Këto konsiderohen si komponentë të rëndësishëm të çdo strategjie për t'iu kundërvënë kërcënimit të ekstremizmit të dhunshëm<sup>24</sup>. Megjithatë, disa pakënaqësi të shfrytëzuara nga grupet e dhunshme ekstremiste shkojnë përtej mundësive qeveritare. Aktorët e shoqërisë civile shpesh ruajnë një pozicion të qartë, të besueshëm, të informuar

24 Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Sesioni i shtatëdhjetë A/A/70/674)

dhe me përvojë, kur bëhet fjalë për ndërhyrje ndaj grupeve të veçanta, për identifikimin dhe trajtimin e pakënaqësive që i bëjnë individët më të prekshëm ndaj VERLT.

Dokumente të ndryshme politikash të OSBE-së gjatë viteve të fundit, veçanërisht Deklarata Ministeriale 4/15, ka inkurajuar shtetet pjesëmarrëse të punojnë në të gjithë sektorët dhe të angazhojnë shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë të komunitetit në mënyrë proaktive për P/CVERLT<sup>25</sup>. Një nga avantazhet kryesore të kësaj qasje është roli përkatës në çdo ndërhyrje. Në fakt janë mungesa e llogaridhënies së qeverisë, përjashtimi social dhe politik ato që ndonjëherë e nxisin ekstremizmin e dhunshëm. Ekzistojnë disa arsye për të cilat shoqëria civile vazhdon të jetë kritike në lidhje me P/CVERLT:

- Shoqëria civile ka **kapacitete dhe përvojë** me zbatimin e programeve që nxisin paqen dhe gjithëpërfshirjen si dhe zbutjen e boshllëqeve strukturore që ndihmojnë në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm. Edhe pse jo drejtpërdrejt të lidhura me P/CVERLT, ato shpesh konsiderohen të rëndësishme për të adresuar P/CVERLT. Disa nga këto programe përqendrohen në garantimin e paqes, riintegrimin e popullatës së prekur nga lufta, qeverisjen e mirë dhe shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, të drejtat e grave dhe çështjet gjinore, dialogun ndërfaqetor dhe transformimin e konflikteve, angazhimin e rinisë, parandalimin e krimit dhe parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike, etj.
- Përpjekjet e shoqërisë civile shpesh janë të rrënjosura tek qytetarët, **të cilët kanë akses, legjitimitet dhe ndikim dhe nxiten** nga shqetësimi real për mirëqenien dhe sigurinë e komuniteteve vendore. Kjo i bën ata aleatë të besueshëm, të cilët janë të gatshëm të jenë novatorë, të gjithanshëm dhe më të përgatitur për të ndërmarrë rreziqe, për komunitete më të sigurta.
- Shoqëria civile shpesh ka **njohuri të gjera** për dinamikën lokale, tendencat dhe faktorët shtytës të ekstremizmit të dhunshëm dhe **mekanizmat më të mirë “për paralajmërimin e hershëm”** të kërcënimeve në zhvillim. Kjo e pozicionon atë si të denjë për të siguruar ndërhyrje në kohë dhe përgjigje specifike për kontekstin.

---

25 Shih "Forcimi i bashkërendimit dhe koherencës në përpjekjet e OSBE-së për të trajtuar kërcënimet transnacionale" (OSBE MC.DEC / 9/11), "Roli i OSBE-së për luftimin e fenomenit të luftëtarëve të huaj terroristë në kontekstin e zbatimit të Rezolutës së Sigurisë së Kombeve të Bashkuara (MC.DOC / 4/15), dhe "Forcimi i përpjekjeve të OSBE-së për të parandaluar dhe për të luftuar terrorizmin MC.DOC / 1/16).

- Shoqëria civile shpesh punon me grupe të marginalizuara, nxit pjesëmarrjen politike dhe **siguron mundësi për trajtimin e kërkesave dhe pakënaqësive**. Këto mundësi mund të ndihmojnë për shpërndarjen e tensioneve midis autoriteteve qeveritare dhe komuniteteve, mund të sfidojnë narrativat e ekstremizmit të dhunshëm dhe kundërshtojnë përpjekjet e grupeve të dhunshme për të përdorur ankesat/pakënaqësitë e komunitetit për qëllime rekrutimi.
- Shoqëria civile mund të lidhet në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar me një komunitet më të madh aktorësh dhe profesionistësh të shoqërisë civile që punojnë në disiplina përkatëse. Duke qenë të rrënjosura në nivelin lokal, por edhe më gjerësisht të lidhura, organizatat e shoqërisë civile janë të pozicionuara për të shkëmbyer praktika të mira dhe për t'i përsosur praktikatat ekzistuese<sup>26,27,28,29</sup>.

## 3.2 Aktorët kryesorë të shoqërisë civile në P/CVERLT

**Të rinjtë, gratë dhe përfaqësuesit e komuniteteve**, duke përfshirë udhëheqësit fetarë, janë aktorë kryesorë të shoqërisë civile, të cilët mund të japin kontribute efektive dhe të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar VERLT. Kuadri strategjik i P/CVERLT dhe dokumentet e politikave kërkojnë vëmendje dhe mbështetje për këta aktorë specifikë. Të rinjtë dhe gratë, në veçanti, njihen si agjentë të ndryshimeve shoqërore dhe si partnerë të çmuar në përpjekjet për P/CVERLT. Përfaqësuesit e komuniteteve janë kritikë për nxitjen e kulturave të tolerancës dhe dialogut të hapur, dhe për të punuar me pjesëtarët e komuniteteve të prekshme, në luftë kundër ideologjivë të dhunshme<sup>30,31</sup>.

26 10 Arsyet pse shoqëria civile është aleat dhe jo kundërshtar në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (Global Solutions Exchange, 2017)

27 Angazhimi i shoqërisë civile në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm: Eksperiencia me Strategjinë Globale të OKB-së kundër Terrorizmit (van Ginkel, ICCT Hague, 2012).

28 Mik jo armik: Hapja e hapësirave për angazhimin e shoqërisë civile për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm (Cortright et al., 2011).

29 Deklarata e Barcelonës: Plani i veprimit të shoqërisë civile euromesdhetare për të parandaluar të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm (Observatori për parandalimin e dhunës ekstremiste, 2017)

30 Plani i veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, seanca e shtatëdhjetë A/A/70/674)

31 Konkluzionet e Këshillit për Shërbimin e Jashtëm të BE-së për kundërterrorizmin, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Këshilli i Bashkimit Evropian, Bruksel (19 qershor 2017).

#### Të rinjtë

Të rinjtë janë objektivi kryesor i përpjekjeve për rekrutim dhe mobilizim nga organizatat e dhunshme ekstremiste. Pavarësisht pozitës gjeografike, fesë, përkatësisë shoqërore ose nivelit arsimor, të rinjtë përbëjnë grupin shoqëror më të prekshëm nga ekstremizmi i dhunshëm. Psikologët ia atribuojnë këtë ndjeshmëri disa faktorëve, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kërkimin e identitetit nga të rinjtë, gjetjen e kuptimit të jetës, shoqërisë, qëllimit, njohjes dhe përkatësisë. Karakteri i natyrshëm shpërthyes dhe gatishmëria për të marrë përsipër rreziqe më të mëdha mund të jenë faktorë kontribues për prirjen e të rinjve për t'u bashkuar me grupe ose lëvizje që përkrahin dhunën<sup>32,33</sup>.

Kuptohet që, sipas kësaj logjike, të rinjtë mund të jenë gjithashtu një nga burimet strategjike të luftës kundër VERLT nëse energjisë, aktivizimit dhe ideve të tyre novatore u jepet mbështetja e duhur dhe nëse ata kanalizohen në mënyrë konstruktive. Plani i veprimit i Kombeve të Bashkuara për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm thekson rëndësinë për vëmendje të veçantë ndaj 1.8 miliardë të rinj dhe të reja në mbarë botën, partnerë të çmuar në P/CVERLT; si dhe u kërkon Shteteve Anëtare të Kombeve të Bashkuara të identifikojnë instrumentet e duhura për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve në kauzën për paqe dhe siguri<sup>34</sup>. OSBE bën thirrje për angazhimin dhe fuqizimin e të rinjve përmes: krijimit të mundësive për pjesëmarrje në jetën publike në promovimin e të drejtave të njeriut, dialogut dhe parimeve demokratike; lehtësimin e aksesit të tyre në shërbime sociale; dhe rritjen e mundësive arsimore e akses në punësim<sup>35</sup>.

Përfaqësuesit e të rinjve, aktivistët, vullnetarët dhe profesionistët e rinj shpesh angazhohen në mënyrë efektive në programet parandaluese në nivel vendor, si *offline* dhe *online*, duke angazhuar bashkëmoshatarët dhe/ose komunitetet e tyre, duke rritur ndërgjegjësimin për pasojat negative ndaj rekrutimit nga grupe terroriste dhe duke ofruar alternativa idesh pozitive. Lehtësimi i dialogut është një fushë tjetër e përbashkët e praktikës për të rinjtë. Kjo qasje praktike ofron mundësi për reflektim dhe debat konstruktiv mbi tema, që lidhen me zhvillimin personal dhe shoqëror, arsimimin, pavarësinë, drejtësinë, nderin, identitetet, normat gjinore, përkatësinë, pajtimin pas konfliktit etj. Tema të tjera për të eksploruar, të cilat kërkojnë ndihmë nga këshillues profesionistë, përfshijnë, ndër të tjera, trajtimin e stresit posttraumatik, diskriminimit, intolerancës, dhunës në familje.

32 Lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm që çon në terrorizëm: ide, rekomandime dhe praktika të mira nga rajoni i OSBE-së (Neumann, OSBE 2017)

33 Angazhimi i shoqërisë civile për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Eksperiencat me Strategjinë e Kundërterrorizmit Global të OKB-së (van Ginkel, ICCT Hagë, 2012). Angazhimi i të rinjve për të luftuar ekstremizmin dhe radikalizimin e dhunshëm që çon në terrorizëm: Raport mbi gjetjet dhe rekomandimet (Sekretariati i Përbashkët i OSBE-së dhe Tria e rumbullakët e ekspertëve të ODHR-it të OSBE-së, 2012)

34 Plani i veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, seanca e shtatëdhjetë A/A/70/674).

35 Parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm që çon në terrorizëm (OSBE, 2015, Deklarata Ministeriale MC.DOC / 4/15).

### Gratë dhe aspektet gjinore

Ekziston një konsensus i gjerë ndërkombëtar midis politikëbërësve dhe profesionistëve se përpjekjet për të angazhuar gratë në P/CVERLT duhen shtuar. Përqendrimi te përpjekjet ndërkombëtare për paqen dhe sigurinë u theksua me miratimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë<sup>36</sup> dhe, më konkretisht, në lidhje me P/CVERLT nëpërmjet hartimit të Rezolutës 2242 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2015)<sup>37</sup>.

Ky intensifikim i angazhimit të grave mund të konsiderohet pozitiv për shkak të qasjeve analitike ndajdinamikës gjinore rreth radikalizmit terrorist dhe adresimit të njohurive të mbledhura nga politikat e P/CVERLT dhe veprimtarinë programatike<sup>38,39</sup>. Gjinia i referohet roleve, sjelljeve, nevojave dhe pritshmërive të ndërtuara mbi modelet sociale që konsiderohen të përshtatshme për gratë dhe burrat në një shoqëri të caktuar. Këto role konsiderohen kontekstuale, të ndryshueshme dhe specifike në kohë<sup>40</sup>.

Perspektiva gjinore (dmth shqyrtimi i dallimeve midis roleve gjinore) është e rëndësishme në punën për P/CVERLT sepse hedh dritë mbi dinamikën ekzistuese të fuqisë brenda një konteksti të caktuar socio-kulturor (psh., lidhur me çfarë pritet, lejohet dhe vlerësohet te një burrë ose te një grua, si dhe nga proceset vendimmarrëse). Përdorimi i perspektivës gjinore siguron një kuptim më të thelluar të mënyrës se si burrat angazhohen ndryshe nga gratë në VERLT; Përveç kësaj, kuptohet më mirë mënyra sesi ekstremizmi i dhunshëm prek secilin prej tyre. Kjo lloj analize ndihmon për identifikimin e mundësive efektive të angazhimit të grave në P/CVERLT. Ndikimi pozitiv i qasjes gjinore ndaj sfidave të sigurisë tashmë është testuar me sukses. Integrimi i një perspektive gjinore dhe përfshirja e grave në proceset paqeruajtëse kanë shtuar efektivitetin dhe mundësitë e zgjidhjes<sup>41</sup>.

Studimet kërkimore mbi rolin e grave në veprimtarinë terroriste adresojnë keqkuptimin që ekziston në trajtimin e grave ose si viktime ose si mbështetëse pasive të ekstremizmit të dhunshëm<sup>42</sup>. Në fakt, gratë luajnë disa role aktive në organizatat ekstremiste të dhunshme, si mbledhja e informacionit, rekrutimi

36 Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2000) (Kombet e Bashkuara, 2000, S/RES/1325).

37 Rezoluta e Kombeve të Bashkuara 2242 (2015) (Kombet e Bashkuara, 2015, S/RES/2242).

38 Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (2000) (Kombet e Bashkuara, 2000, S/RES/1325).

39 Bota e njeriut? Eksplorimi i roleve të grave në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm (ed. Fink, Zieger, Bhulai, Hedayah dhe Qendra Globale për Sigurimin e Përbashkët, 2016).

40 Integrimi gjinor: Strategjia për promovimin e barazisë gjinore (Zyra e Këshilltarit të Posaçëm për Çështjet Gjinore dhe Avancimin e Grave, UN Women, 2001).

41 Bota e njeriut? Eksplorimi i roleve të grave në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm (ed. Fink, Zieger, Bhulai, Hedayah dhe Qendra Globale për Sigurimin e Përbashkët, 2016).

42 Gratë dhe radikalizmi terrorist, Raporti Përfundimtar (Sekretariati i OSBE-së dhe ODIHR, 2011).

dhe mobilizimi i burimeve, ose kryerja e sulmeve vetëvrasëse<sup>43</sup>. Organizatat ekstremiste të dhunshme ndonjëherë i përdorin luftëtarët femra si mjet taktik për t'i poshtëruar dhe turpëruar burrat dhe për t'i bërë ata të bëhen pjesë e tyre, duke luajtur kështu me natyrën patriarkale dhe normat gjinore<sup>44</sup>. Një vlerësim objektiv i përfshirjes së grave në aktivitetet e ekstremizmit të dhunshëm në çdo kontekst ndihmon për eliminimin e stereotipeve gjinore dhe për përmirësimin e kuptimit të roleve të ndryshme që ato mund të luajnë për P/CVERLT.

Ndërkohë që konsiderohen si aktore të rëndësishme në praktikën e P/CVERLT, gratë nuk mund ta arrijnë potencialin e tyre të plotë si agjente të ndryshimeve pozitive në ato shoqëri ku ato konsiderohen padukshme në hapësirën publike dhe të margjinalizuara në jetën private. Fuqizimi i tyre është një kusht thelbësor për angazhim efektiv në hapësirën e P/CVERLT. Studimet tregojnë për një lidhje të fortë midis fuqizimit të grave dhe reduktimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe anasjelltas, midis pabarazisë gjinore dhe konfliktit të dhunshëm<sup>45</sup>. Angazhimi gjithëpërfshirës i grave në P/CVERLT kërkon përfshirjen e tyre në politikëbërje dhe përfaqësim në sektorët e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit. Kjo garanton përfshirje të vërtetë dhe aspak “me përzgjedhje” apo simbolike.

Gratë mund të ushtrojnë ndikim mbi përpjekjet për P/CVERLT si hartuese politikash, udhëheqëse politike, edukatore, nëna, anëtare komuniteti dhe aktiviste. Ato mund të formojnë dhe të udhëheqin programet e edukimit, të angazhohen aktivisht me të rinjtë e prekshëm dhe të jenë aktore të narrativës kundër ekstremizmit, veçanërisht kur flasin si viktimë, ose si të mbijetuara nga sulmet terroriste, por edhe si ish- ekstremiste të dhunshme. Një ndër rolet kryesore që ato mund të luajnë në P/CVERLT lidhet me aftësinë e tyre për të ndërhyrë drejtpërdrejtë me vajzat dhe gratë në rrezik radikalizimi terrorist, ose të radikalizuara, si dhe me vajzat dhe gratë që janë kthyer nga zonat e konfliktit në vendet e huaja, ku mund të kenë qenë të përfshirë në konflikt të armatosur. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në komunitetet kulturore konservatore.

Është e rëndësishme të pranohet gjithashtu roli që baballarët mund të luajnë në procesin e P/CVELRT, veçanërisht në përpjekjet për integrim gjinor dhe programet familjare dedikuar P/CVERLT. Për shkak të rolit të tyre në mjedisin familjar, ata mund të jenë të dobishëm për formimin e koncepteve pozitive larg dhunës dhe stereotipeve të maskulinitetit. Sidoqoftë, ky potencial duhet shqyrtuar në vijim dhe duhet të përdoret në mënyrë të përshtatshme në programet për P/CVERLT. Nxitja e studimeve të reja mbi rolin e baballarëve

43 "Gratë e arratisura nga ISIS-i përshkruajnë jetën në Brigadën Al-Khansa, ku gratë dënohen me 40 gjujatje me kamzhik për veshjen e rrobave të gabuara" (The Independent, 2015)

44 Nga Lufta e Parë Botërore te ISIS-i, përdorimi i turpit dhe maskulinitetit në narrativat e rekrutimit (START, 2016).

45 Gratë dhe Luftimi i Ekstremizmit të Dhunshëm (Idris, GSDRC 2017).



në lehtësimin dhe zbutjen e ndikimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm, do të ishte një hap i rëndësishëm drejt integritimit efektiv të perspektivës gjinore në programet P/CVERLT<sup>46</sup>.

### Përfaqësuesit e komuniteteve

**Ata** mund të luajnë rol të rëndësishëm ndërmjetësish midis komuniteteve dhe autoriteteve qeveritare. Partneritetet janë të dobishme për trajtimin e një sërë shqetësimesh të lidhura me sigurinë publike që përfshijnë edhe P/CVERLT. Puna me udhëheqësit e komunitetit për të krijuar ndjenjën e qëllimit të përbashkët mbi P/CVERLT është një investim i mirë, i cili çon në rezultate të suksesshme<sup>47</sup>.

Udhëheqja e komunitetit nuk kufizohet në stereotipet tradicionale dhe, për këtë arsye, do të ishte mirë të kishte angazhim në një sferë të gjerë të anëtarëve të komunitetit, pa dallim moshe, gjinie, përkatësie etnike dhe besimi kur kërkohet identifikimi dhe angazhimi i udhëheqësve të komunitetit. Udhëheqësit fetarë përfaqësojnë një formë të veçantë të udhëheqjes së komunitetit dhe komunitetet fetare janë disa nga institucionet më të organizuara civile në botë. Udhëheqësit fetarë shërbejnë jo vetëm si udhëheqës shpirtërorë, por dhe si vendimmarrës me ndikim popullor dhe politik në një komunitet<sup>48</sup>. Në këtë mënyrë, roli i udhëheqësve fetarë në P/CVERLT e tejkalon fushën e doktrinës fetare. Përtej „antidotit teologjik ndaj interpretimeve ekstremiste të fesë“, mund të angazhohen aktorë fetarë në P/CVERLT në role më të gjera dhe të shfrytëzohet ndikimi i tyre në qeverisje, zhvillim dhe ndërtimin e paqes<sup>49</sup>.

Duhet shmangur ato ndikime të veçuara që instrumentalizojnë aktorët e komunitetit ose aktorët fetarë për të mbledhur dhe raportuar informacion pranë autoriteteve qeveritare.. Ndërkohë që siguria është shqetësimi i të gjithëve, pozicionimi i komunitetit fetar dhe i udhëheqësve fetarë si informatorë e dëmton besueshmërinë dhe pozicionimin e tyre brenda komunitetit. Është e rëndësishme të kuptojmë se, në disa raste, udhëheqësit fetarë kanë pikëpamje joliberalë dhe madje edhe ekstremistë, dhe nxisin idetë intolerante. Përfshirja e udhëheqësve fetarë dhe ideologjikisht ekstremë, por jo të dhunshëm mund të pengojë P/CVERLT.

Udhëheqësit e komunitetit mund të kenë ndikim në një sërë përpjekjesh, duke filluar nga parandalimi në fazën e hershme deri te rehabilitimi dhe riintegrimi i autorëve të dhunshëm ekstremistë dhe luftëtarëve të huaj që kthehen. Si aktorë të besueshëm, me njohuri unike mbi çështje të ndjeshme për pjesëtarët e

46 Roli i familjeve për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm: rekomandimet strategjike dhe mundësitë e programimit (Forumi Global për Luftën kundër Terrorizmit, 2016)

47 Memorandumi i Ankarasë për Praktikën e Mira për një Qasje Shumësektoriale për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (Forumi Global për Luftën kundër Terrorizmit, 2012 dhe 2013).

48 Angazhimi i fesë dhe aktorëve fetarë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (Mandaville dhe Nozell, USIP 2017).

49 Po aty.

cenueshëm të komunitetit, ata mund të jenë komunikues efektivë të alternativës kundër dhunës. Ata mund të përdorin pozitën e tyre, autoritetin, bësueshmërinë e figurës së tyre dhe lidhjet e ngushta me anëtarët e komunitetit për të orientuar të rinjtë drejt vlerave të paqes dhe tolerancës dhe për të ndërtuar rezistencë ndaj mesazheve të urrejtjes<sup>50</sup>.

## 3.3 Aktorë të tjerë të rëndësishëm në P/CVERLT

Efektiviteti i qasjes “së integruar të shoqërisë” ndaj P/CVERLT varet nga pjesëmarrja aktive dhe e vazhdueshme e një sërë aktorësh në zbatimin e saj. Përveç aktorëve kryesorë të shoqërisë civile të përshkruar më lart, ka aktorë të tjerë të rëndësishëm që përfshijnë edukatorët/mësuesit, profesionistët ligjzbatues, akademikët/studiuuesit, ish-ekstremistët e dhunshëm, profesionistët e teknologjisë së informacionit dhe medias, gazetarët dhe specialistët e medias. Është e rëndësishme që të njihet ndikimi i aktorëve me pikëpamje të ndryshme brenda komunitetit, si edhe organizatat formale dhe informale vendore, të cilat mund të ushtrojnë ndikim negativ mbi programin e P/CVERLT. Në vijim, jepet një trajtim gjithëpërfshirës, jo shterues i spektrit të aktorëve me ndikim të drejtpërdrejtë dhe pozitiv në këtë fushë.

- **Edukatorët/mësuesit/shkollat** – Shkollat veçanërisht janë të ndjeshme ndaj VERLT, pasi konsiderohen rrugë të ndërveprimit shoqëror për të rinjtë në ndërtimin e identiteteve të tyre personale dhe shoqërore. Edukatorët, si profesionistë të vijës së parë, janë çelësi për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, jo vetëm për shkak të aftësisë për të dhënë njohuri, me anë të të cilës ata mund të ushtrojnë ndikim mbi botëkuptimin dhe sistemin e vlerave të studentëve, por edhe për faktin se ata mund të identifikojnë individët e cenueshëm nga ndikimet dhe në nevojë për mbështetje. Trajnimi i mësuesve për të kuptuar rreziqet e VERLT dhe për t’iu qasur situatës në mënyrë të kujdesshme dhe konstruktive është investim kritik. Ata mund të mbështesin përpjekjet për P/CVERLT, nëpërmjet përgatitjes së kurrikulave dhe teksteve që nxisin respektin për diversitetin dhe promovojnë normat shoqërore jo të dhunshme. Mësuesit mund të luajnë një rol të vyer për rehabilitimin dhe riintegrimin duke ofruar trajnime teknike profesionale dhe programe për të rritur aftësitë kognitive ndaj autorëve të dhunshëm dhe ekstremistë në

50 Qasjet qytetare për përballjen me ekstremizmin e dhunshëm: Rekomandimet e sektorit dhe praktikant më të mira (Barzegar et al., Raport i financuar nga Bashkimi Evropian, Universiteti Shtetëror i Gjeorgjisë, Këshilli Britanik dhe Instituti për Dialog Strategjik, 2016).

përgatitjen për rikthim në shoqëri<sup>51</sup>.

Me gjithë vlerësimin për rolin e rëndësishëm të mësuesit/edukatorit në arritjen e rezultateve të dobishme; duhet vlerësuar sadopak rreziku se ndikimi i mësuesit/edukatorit mbi mendjet dhe sjelljet e nxënësve jo gjithmonë mund të jetë efektiv. Edukatorët dhe institucionet arsimore që tolerojnë dhunën e çdo lloji nuk mund të jenë partnerë të përshtatshëm për P/CVERLT<sup>52</sup>.

- **Shërbimet e zbatimit të ligjit /të policimit në komunitet** – Shërbimet e policisë janë përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Praktika e policimit në komunitet thekson “përpjekjet e bashkëpunimit midis policisë dhe komunitetit për të identifikuar, parandaluar dhe zgjidhur problemet me krimin, rreziqet e mundshme për krime, çështjet e sigurisë dhe sigurisë fizike, trazirat shoqërore dhe problemet e fqinjësisë së qetë dhe pa trazira, dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë”. Në kuadrin e P/CVERLT, pikënisja është bashkëpunimi i ngushtë, i bazuar te besimi i ndërsjelltë ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit dhe komuniteteve për zvogëlimin e tensioneve dhe pakënaqësive, përmirësimin e aftësisë ndërhyrëse në ciklin e radikalizmit terrorist, reduktimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike dhe komunitete më të afta për t’ju përgjigjur situatës<sup>53</sup>.

Partneritete të tilla janë investime afatgjata që kërkojnë durim, përpjekje të vazhdueshme dhe angazhim në terren. Ekspertët theksojnë se këto përpjekje japin rezultate të vërteta nëse komponentët e policimit në terren reflektojnë diversitetet racor, etnik dhe fetar të komuniteteve që adresohen. Për më tepër, zhvillimi i politikave të qarta dhe transparente, të cilat koordinojnë kontakte, mbledhin dhe administrojnë informacion të fshehtë dhe hetime penale, shkon më tej drejt besimit të përbashkët dhe efektivitetit të angazhimit të policisë në P/CVERLT<sup>54</sup>. Bordet këshilluese komunitare ose këshillat e sigurisë kanë provuar të jenë forume efektive për ngritjen dhe trajtimin e çështjeve përkatëse të P/CVERLT. Ato janë gjithashtu platforma të dobishme dhe transparente për angazhimin e shoqërisë civile dhe të udhëheqësve të komunitetit, për reagime ndaj organeve të zbatimit të ligjit në përpjekjet e vazhdueshme për të koordinuar ndërhyrjet e mundshme.

- **Akademikët/studiuuesit** – Efektiviteti i politikave të P/CVERLT është i lidhur me cilësinë e studimeve dhe analizave që mbështesin zhvillimin e tyre, dhe

51 Memorandumi i Romës mbi praktikën e mira për rehabilitimin dhe riintegrimin e autorëve të ekstremizmit të dhunshëm (Forumi Global kundër Terrorizmit, 2012).

52 Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes arsimit: udhëzues për politikëbërësit (UNESCO, 2017).

53 Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm: qasje e policimit në komunitet (OSBE TTD dhe ODIHR, 2014)

54 Sfidat dhe premtimi i përdorimit të strategjive të policimit në komunitet për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm: thirrje për partneritete në komunitet me organet e zbatimit të ligjit për të përmirësuar sigurinë publike, raport përfundimtar (Schanzer et al., NCJRS, 2016)

që udhëzojnë zbatimin e programeve të ndërhyrjes. Prandaj, integrimi i studiuesve me përvojë, i instituteve kërkimore dhe institucioneve akademike në proceset e hartimit të politikave P/CVERLT dhe në zbatimin e programeve është me rëndësi strategjike. Përpjekjet për studime drejt P/CVERLT, të bazuara në prova dhe teknika rigoroze, si dhe metodologji vlerësimesh objektive, mund të identifikojnë me saktësi shkaqet dhe tendencat dinamike të radikalizmit terrorist. Nga ana tjetër, kjo mund të ndihmojë për hartimin e përgjigjeve efektive sipas nevojës.

Megjithatë, mundësitë për studime mund të mos jenë të mundshme, ndaj aktorët qeveritarë duhet të konsiderojnë trajnimin e vazhdueshëm dhe ngritjen e kapaciteteve për studiuesit si një nga linjat kryesore të P/CVERLT. Cilësia e studimit varet nga aksesit në informacion. Në këtë mënyrë, përmes lehtësimit të aksesit të studiuesve në të dhëna të rëndësishme dhe të besueshme, sistematikisht dhe periodikisht mund të kontribuojë në vlerësime dhe politika më të mira. Një hap tjetër për të zhvilluar një qasje strategjike ndaj P/CVERLT është krijimi i forumeve të politikave për të diskutuar mbi përparësitë e politikave, për të shpërndarë gjetjet e studimeve dhe për të lehtësuar shkëmbimet e rregullta midis studiuesve, politikëbërësve dhe profesionistëve.

- **Ish-ekstremistët e dhunshëm ose “ishët”** – Procesi i përfshirjes së “individëve të cilët janë shkëputur nga VERLT,<sup>55</sup> paraqet njëkohësisht mundësi dhe rreziqe. Për shkak të përvojës së tyre të mëparshme me radikalizmin terrorist, rekrutimin apo mobilizimin, ata mund ta njohin mirë procesin dhe të kenë njohuri të dobishme për mënyrën e parandalimit. Statusi i tyre si individë, të cilët ose i kanë mbështetur ose janë përfshirë në aktivitete të lidhura me terrorizmin, mund t’u japë atyre më shumë besueshmëri për audiencat në rrezik dhe mund t’i bëjë ata komunikues legjitimë dhe efektive kundër ekstremizmit të dhunshëm. Ata mund të lidhen me audiencat në një nivel më të thellë dhe personal. Përmes tregimit të historive dhe përvojës së tyre, ata mund të ndihmojnë në demitizimin e historive të ekstremizmit të dhunshëm, të dëshmojnë se shkëputja mund të ndodhë dhe se ndërtimi i një jete të re është gjithmonë i mundur. Për pasojë, “ishët” mund të luajnë një rol të dobishëm në një gamë të gjerë të përpjekjeve për P/ CVERLT nga ndërgjegjësimi dhe komunikimi i historive të besueshme, deri te programet e mbështetjes së OShC-ve, të cilat përqendrohen te shkëputja ose rehabilitimi dhe riintegrimi i ekstremistëve të dhunshëm që kanë vuajtur dënimin e tyre.

Megjithatë, disa nga individët e tërhequr nga mjediset ekstremiste janë të gatshëm dhe të aftë të marrin pjesë në përpjekjet për P/CVERLT edhe kur e bëjnë këtë gjë,

<sup>55</sup> Parandalimi i terrorizmit dhe kundërshtimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që çojë në terrorizëm: qasja e policimit në komunitet (OSBE dhe ODIHR, 2014).

ata kërkojnë trajnim, mbështetje dhe mbikëqyrje të plotë. Gjithashtu, shkëputja nga ekstremizmi i dhunshëm nuk është proces linear ose i përhershëm, dhe rikthimi në terrorizëm përbën një rrezik të vazhdueshëm. Një nga detyrimet kryesore të shoqëruara me regjistrimin e “ishëve” për të mbështetur programet e deradikalizimit/shkëputjes ka qenë që, ndonjëherë, pavarësisht heqjes dorë nga dhuna aktive, ata kanë vazhduar të ruajnë pikëpamje që nxisin intolerancën, duke minuar kështu përpjekjet për rehabilitimin e të tjerëve<sup>56</sup>. Ishët” mund të jenë më së miri të pozicionuar për rolet plotësuese në përpjekjet për P/CVERLT pas kryerjes së trajnimeve të plota, testeve të rregullta dhe vlerësimeve të rrezikut<sup>57</sup>.

- **Spektori i teknologjisë së informacionit (IT) dhe medias sociale** – Revolucioni i internetit dhe i mediave sociale ka thyer barrierat tradicionale të komunikimit, duke krijuar një botë aktive në komunikim. Organizatat e dhunshme ekstremiste njohin dhe shfrytëzojnë fuqinë dhe mundësitë e pakrahasueshme që ofrojnë platformat e mediave sociale, duke i përdorur ato për të frymëzuar, rekrutuar dhe mobilizuar mbështetje, për të nxitur luftë psikologjike, për të nxitur dhe koordinuar sulme, e për të mbledhur fonde. Propaganda e tyre i referohet platformave të medias si mjete me rëndësi të krahasueshme me armët vdekjeprurëse që përdoren në fushën e betejës. Duke pasur parasysh përdorimin strategjik dhe taktik të internetit dhe të medias sociale nga ekstremistët e dhunshëm, sektori i IT-së ka rol të rëndësishëm për ndërprerjen e përdorimit abuziv të platformave të tij, dhe mbështetjen e iniciativave P/CVERLT të shoqërisë civile.

Shumica e platformave kryesore të mediave sociale gjatë viteve të fundit i kanë rritur përpjekjet për përdorimin e abuzimit online dhe gjuhës së urrejtjes në internet, duke çuar në fshirjen/raportimin/ bllokimin e përmbajtjes që promovon ekstremizmin e dhunshëm *online*. Këto përpjekje duhet të bëhen me kujdes dhe brenda parametrit të ligjeve që mbrojnë lirinë e fjalës. Shtimi i një qasjeje proaktive ndaj kësaj sjelljeje reaktive mund të sjellë rezultate edhe më të mira. Në partneritet me OShC-të dhe IT, institucionet që merren me teknologjinë kanë kapacitete dhe burime teknologjike për të zhvilluar strategji dhe fushata komunikimi që sfidojnë narrativat e ekstremizmit të dhunshëm dhe promovojnë kulturën e tolerancës, dialogut dhe mosdiskriminimit. Ato mund të inkurajojnë dhe mbështesin, po ashtu, edhe kërkimet mbi keqpërdorimin dhe shfrytëzimin e platformave të internetit dhe mediave sociale nga organizatat e dhunshme ekstremiste që i ndihmojnë politikëbërësit të zhvillojnë përgjigje më efektive. Përpjekje të tjera mund të përqendrohen në fuqizimin e viktimave për t'u angazhuar në punën P/CVERLT duke u ofruar

56 Luftëtarët e huaj të kthyer dhe domosdoshmëria e riintegritimit (Holmer dhe Shtuni, Instituti Amerikan i Paqes, 2017).

57 Pro-të dhe kundrat e përfshirjes së ishëve në punën PVE/CVE (RAN C & N dhe RAN Exit, 2017).

atyre forume online për të ndarë historitë e tyre<sup>58</sup>.

- **Media/gazetarët** – Revolucioni i internetit në dy dekadat e fundit e ka reformuar mjedisin e medias, ku mjetet e komunikimit masiv nuk janë më ekskluzivitet i gazetarëve profesionistë. Kanalet e mediave të zakonshme po e ngjeshin hapësirën e lajmeve me portale më të vogla lajmesh dhe identifikimi i burimeve të besueshme po bëhet gjithnjë e më sfidues. Mënyra se si mediat i raportojnë çështje ose incidentet e ekstremizmit të dhunshëm ka ndikim të thellë mbi dinamikën e komunitetit, mbi sigurinë dhe përpjekjet për P/CVERLT. Raportimet e njëanshme të lajmeve mund ta polarizojnë komunitetin, të nxisin intolerancën dhe urrejtjen, të përforcojnë ose të përkeqësojnë faktorët e favorshëm për radikalizmin terrorist. Ndërkohë që parimet bazë etike të gazetarisë ofrojnë një kuadër të shëndoshë për mbulimin profesional të lajmeve, raportim mbi një subjekt të ndjeshëm si element i ekstremizmit të dhunshëm kërkon ndërgjegjësime dhe njohuri për ligjet mbi të drejtat e privatësisë dhe prezumimin e pafajësisë.

Roli i gazetarëve të përgjegjshëm, objektivë dhe profesionistë në P/CVERLT nuk kufizohet vetëm në shuarjen e vatrave të “zjarreve dixhitale”<sup>59</sup> të shkaktuara nga informacione të gabuara ose keqdashëse. Gazetarët dhe shoqatat e medias mund të përdorin ekspertizën e tyre për të trajnuar aktorët e shoqërisë civile për zhvillimin dhe shpërndarjen e narrativave të kundërta dhe alternative, fushatave informuese dhe materialeve të ndjeshme në aspektin kulturor për P/CVERLT<sup>60</sup>. Ata mund të sigurojnë gjithashtu hapësirë dhe të amplifikojnë mesazhe pozitive të udhëhequra nga komuniteti. Për më tepër, përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve për profesionistët e mediave mund të përqendrohen në njohuritë bazë dhe terminologjinë e P/CVERLT, ashtu edhe në udhëzimet praktike për shmangien e promovimit të tërthortë të përmbajtjes, imazheve apo mesazheve të ekstremizmit të dhunshëm gjatë raportimit, gjuhës sensacionale ose provokuese, ose stigmatizimit të komuniteteve të caktuara etnike ose fetare.

- **Aktorët jo liberalë të shoqërisë civile** – Puna e OShC-ve është shumë shpesh konstruktive dhe çon në përpjekje dhe programe që promovojnë qeverisjen e mirë dhe luftën kundër korrupsionit, respektin dhe garantimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ndihmën humanitare. Megjithatë, është e rëndësishme të pranohet se shoqëria civile dhe organizatat vendore nuk kërkojnë gjithmonë dhe ekskluzivisht avancimin e paqes, përparimin shoqëror dhe mosdiskriminimin. Për shembull, disa organizata mbështesin objektiva racore dhe diskriminuese. Në disa raste, shoqatat e shoqërisë civile


58 Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, sesioni i shtatëdhjetë A/A/70/674)

59 Zjarre digjitale në një botë të superlidhur (World Economic Forum, 2013).

60 Më i fuqishëm se shpata? Roli i mediave në trajtimin e dhunës dhe terrorizmit në Azinë Jugore (Qendra për Bashkëpunimin Global kundër Terrorizmit, 2013).

kanë promovuar paragjykimet klasore, homofobinë, seksizmin ose shtypjen e personave me aftësi të kufizuara<sup>61</sup>. Në raste të tjera, disa organizata fetare njihen të kenë nxitur dhunën për shkak të racës, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, ose përkatësisë fetare.

Operacionet kundër terrorizmit kanë zbuluar se njësitë që ndonjëherë operojnë formalisht ose joformalisht në trajtën e të ashtuquajturave shoqata kulturore, forume rinore ose organizata bamirësie të bazuara në besim, janë angazhuar në aktivitete të lidhura me terrorizmin, ose kanë kërcënuar dhe synuar aktivistë dhe gazetarë investigativë që flasin kundër ekstremizmit të dhunshëm ose e ekspozojnë atë. Studimet empirike tregojnë se këto organizata të maskuara kanë funksionuar shpesh në komunitetet me pjesëmarrje të lartë në aktivitete të dhunshme ekstremiste<sup>62</sup>. Megjithëse të vëna në shënjestër nga organet e zbatimit të ligjit, në shumë raste, nuk i kanë pushuar aktivitetet e tyre; në fakt, ato janë përshtatur dhe janë shndërruar në formate më klandestine. Marrja parasyshe e pranisë, e motivimit dhe e aktiviteteve të këtyre aktorëve gjatë hartimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve për P/CVERLT është kritike për përmirësimin e efektivitetit, ndikimit dhe sigurisë. Megjithatë, qeveritë duhet të kenë dëshmi të qarta për veprimtarinë kriminale dhe qëllimin e organizatave të tilla përpara se t'i shënjestrojnë ato, në mënyrë që grupet të mos censurohen në mënyrë të padrejtë ose të papërshtatshme thjesht sepse kanë pikëpamje të kundërta ose mendim ndryshe.



61 Drejt një politikë globale: Tendencat e ardhshme dhe perspektivat (Higgott, Morten Ougaard, ed., Routledge, 2002).

62 Dinamikat e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë (Shtuni, USIP, 2016).





# 4. Konteksti i Evropës Juglindore



Evropa Juglindore ka bërë shumë përparime gjatë dekadave të fundit për sa i përket zhvillimit të një shoqërie civile dinamike dhe pluraliste. Pavarësisht sfidave të vazhdueshme, shoqëria civile e ka pozicionuar në mënyrë të qëndrueshme veten në ballë të lëvizjeve transformuese që synojnë ta pozicionojnë rajonin larg së shkuarës së tij autoritare, të karakterizuar nga luftëra sektare dhe nga një rrugë e gjatë transformimesh demokratike dhe pajtimi. Numri dhe larmia e OShC-ve është rritur në mënyrë të vazhdueshme, ndonëse ky realitet nuk flet domosdoshmërisht për efektivitetin. Angazhimi i tyre është përqendruar te larmishmëria e përpjekjeve për ndërtimin e paqes, stabilitetin, çështjet pas konfliktit, demokratizimin, qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit.

Pas konflikteve të armatosura të viteve 1990 në rajon janë krijuar shumë OShC, kryesisht për zbatimin e programeve të financuara nga jashtë, të dedikuara për ndihmë humanitare dhe rindërtim. Disa prej këtyre OShC-ve u transformuan gradualisht në mekanizma të specializuar për të mbështetur qeverisjen e mirë dhe për nxitjen e institucioneve publike transparente dhe të përgjegjshme, të tjera organizata përqendrohen në promovimin e të rinjve, të grave dhe të drejtave të pakicave, e të tjera kontribuojnë për procesin e pranimit në Bashkimin Evropian<sup>63</sup>.

Pavarësisht arritjeve, shoqëria civile në Evropën Juglindore pasqyron probleme strukturore të shoqërive të tyre përkatëse. Pavarësisht karakterit të ndryshëm të çështjeve në rajon, shoqëria civile në Evropën Juglindore përshkruhet e fragmentuar dhe etnikisht e segmentuar, bazuar pamjaftueshmërisht tek anëtarësimet, e varur financiarisht dhe politikisht nga mbështetja e donatorëve

63 "Perceptimet e analizës së pulsit të publikut për shoqërisë civile në Kosovë" (UNDP, 2016).

ndërkombëtarë dhe që pjesërisht reflekton dhe trajton shqetësimet përparësore të anëtarëve të saj<sup>64,65,66</sup>.

Vlerësimet e organizatave ndërkombëtare përmbajnë disa nga këto konkluzione. Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) mat fuqinë dhe qëndrueshmërinë e sektorëve të shoqërisë civile dhe nivelin e përgjithshëm të zhvillimit të saj. Ai analizon shtatë komponentë kryesorë: kuadrin ligjor, kapacitetin organizativ, qëndrueshmërinë financiare, advokimin, ofrimin e shërbimeve, infrastrukturën dhe imazhin publik. Sipas Indeksit të Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile të vitit 2016, qëndrueshmëria e përgjithshme në Evropën Juglindore nuk ka parë shenja përmirësimi gjatë dekadës së fundit. Fushat ku OShC-të vlerësohen për rezultate të larta janë infrastruktura dhe advokimi, ndërsa qëndrueshmëria financiare vlerësohet vazhdimisht me rezultatin më të ulët, duke dëshmuar një varësi kronike nga donatorët e huaj, „thembra e Akilit“ e OShC-ve në Evropën Juglindore<sup>67</sup>.

Edhe pse një fenomen dytësor, një zhvillim tjetër në rajon ka qenë shfaqja e „shoqërisë civile joliberalë“, përfaqësuar nga grupe që përkrahin pikëpamjet ultranacionaliste dhe intolerante, ose që shfaqin një preferencë përzgjedhëse duke shtuar diskriminimin dhe duke rrënjosur paragjykime ose forma të ekstremizmit<sup>68</sup>. Në disa raste të tjera, aktorët politikë populistë kanë përdorur mediat shtetërore ose platforma të tjera të mediave për të sulmuar shoqërinë civile si agjente e financuar nga jashtë që minon interesat kombëtare. Këto zhvillime janë shpesh një manifestim i drejtpërdrejtë i dinamikave rajonale që shkojnë përtej kufijve politikë. Ato janë pasqyrim i një prirjeje më të gjerë globale për çrrënjosjen e vlerave demokratike dhe të lirive themelore<sup>69,70</sup>.

Takimi i Grupit të Punës i Ekspertëve të Evropës Juglindore për P/CVERLT, mbledhur nga TNTD/ATU për qëllimet e këtij udhëzuesi, ka identifikuar një sërë sfidash dhe mundësish me të cilat përballen OShC-të në rajon dhe që duhen përmirësuar:

64 "Hartëzimi i organizatave të shoqërisë civile në BIH" (Politika dhe zhvillimi i EPRD-së, 2016).

65 Matrica e monitorimit të mjedisit të përshtatshëm për zhvillimin e shoqërisë civile (Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, 2016).

66 Shoqëria civile dhe tranzicionet në Ballkanin Perëndimor (Perspektivat e reja në Evropën Juglindore) Edicioni i vitit 2013.

67 Indeksi i Qëndrueshmërisë së OShC-së për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Eurazisë (USAID, 2017) 2016.

68 Shoqëria civile dhe tranzicionet në Ballkanin Perëndimor (Perspektivat e reja në Evropën Juglindore) Edicioni i vitit 2013.

69 "Mbështetja e shoqërisë civile në Evropën Lindore dhe Ballkanin Perëndimor" (Fondi Gjerman Marshall i Shteteve të Bashkuara, 2018).

70 Referencë e dobishme për këtë temë është "Përgjegjësia e shteteve: Mbrojtja e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në rajonin e OSBE-së".

#### • Legjitimiteti dhe besueshmëria e OShC-ve

Një ndër sfidat më të shpeshta ka të bëjë me çështjet e legjitimitetit dhe kredibilitetit të pamjaftueshëm që vjen si rezultat i qëllimeve të paqarta, pozicionit oportunist të disa organizatave dhe ndonjëherë edhe nga ndjekja haptazi e axhendave politike prej tyre.

#### • Marrëdhënia ndërmjet OShC-ve dhe qeverive

Duke pranuar se, në përgjithësi, marrëdhënia midis qeverive dhe shoqërisë civile është përmirësuar dukshëm për shkak të vullnetit të ndërsjellë për t'u angazhuar, ekspertët vënë në dukje se OShC-të nuk trajtohen gjithmonë si partnerë të cënueshëm dhe se roli i organizatave rinore në veçanti nuk është përmirësuar mjaftueshëm. Mungesa e kapaciteteve të OShC-ve dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me aktorët e qeverisë vështirëson marrëdhënien kuptimplotë dhe bashkëpunuese.

#### • Koordinimi përkundrejt kontrollit në bashkëpunimin midis OShC-ve/qeverisë

Lidhur ngushtë me sa më sipër, është e rëndësishme të krijohet një kanal i qëndrueshëm koordinimi ndërmjet OShC-ve që veprojnë në fushën e P/CVERLT dhe qeverisë me qëllim rritjen e transparencës dhe garantimin e efektivitetit. Megjithatë, ekspertët theksojnë se ka një vijë të hollë ndarëse midis bashkërendimit dhe kontrollit, ndaj ata tentojnë të bëjnë një hap prapa për të parandaluar që projektet e tyre të drejtohen ose të monitorohen shumë afër nga qeveria.

#### • Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi midis OShC-ve

Ekspertët vënë në dukje se bashkëpunimi ndërmjet OShC-ve në rajon ndryshon nga historiku i veçantë i secilës prej tyre, megjithëse niveli i përgjithshëm i komunikimit dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë është i pamjaftueshëm dhe i rrallë. Rrjetet e shoqërisë civile shpesh përmenden si praktikë e mirë, por lidhjet e rëndësishme rajonale janë të rralla. Edhe pse aktorët e shoqërisë civile shpesh takohen gjatë konferencave, ata nuk angazhohen aq shpesh në përpjekjet për zbatimin e projekteve e përbashkëta.

#### • Mbivendosja e përpjekjeve

Ekspertët vlerësojnë ekzistencën e ideve dhe iniciativave të reja për P/CVERLT, por prirja për të krijuar struktura të reja dhe platforma të dedikuara për çdo sfidë mund të jetë joefikase, sidomos në momentin që vetë sektori ofron disa kapacitete. Këshillat vendorë të sigurisë përmenden në mënyrë të përsëritur si mjete të dobishme të angazhimit në kontekstin e P/CVERLT.

##### • Reputacioni dhe çështjet e sigurisë personale

Kur flitet për përfshirjen në punën për P/CVERLT kemi të bëjmë me çështje reputacioni dhe të sigurisë personale, veçanërisht nëse këto çështje emërohen si të tilla. Nga frika e vënies në rrezik të reputacionit dhe sigurisë vetjake, por edhe për shkak të detyrimeve të mundshme ligjore që mund të vijnë si rezultat i punës me individë të radikalizuar ose të dënuar për krime terroriste, shumë organizata të shoqërisë civile hezitojnë të angazhohen në këtë fushë.

##### • Çështjet e terminologjisë

Disa ekspertë vënë në dukje çështjet e terminologjisë që nuk mund të përkthehen mirë në kontekstin e rajonit, siç janë: „udhëheqësit e komunitetit“ dhe „udhëheqësit e të rinjve“. Më tej, „kundërshtimi i ekstremizmit të dhunshëm“ përkthehet si „luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm“ në të gjitha gjuhët e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, pjesëmarrësit sugjerojnë, gjithashtu, që kjo sfidë nuk duhet të trajtohet duke krijuar terma të reja ose duke përshtatur terminologji specifike gjuhësore, por duke ofruar shpjegime dhe shembuj konkretë.

##### • Mungesa e aksesit

Komunitetet shumë konservatore rrallë ofrojnë mundësi që OShC-të të angazhohen me to. Udhëheqësit fetarë, të cilët gëzojnë besueshmëri më të lartë se të tjerët me komunitete të veçanta, mund të jenë më të aftë për të punuar në këto mjedise.

Sfidat komplekse të renditura më sipër kërkojnë qasje të përshtatura për çdo kontekst të veçantë. Udhëzimet e përkthura në seksionin e mëposhtëm ofrojnë një mundësi për të mësuar nga praktikatat e mira ekzistuese dhe për të zhvilluar përgjigje efektive ndaj këtyre sfidave dhe sfidave të tjera në fushën e P/CVERLT.





# 5. Garantimi i rolit efektiv të shoqërisë civile në P/ CVERLT: Udhëzime dhe praktika të mira



Vetëm rritja e ndërgjegjësimit për rolin kritik të aktivitetit të shoqërisë civile dhe aktivizimin e saj vendor lidhur me P/CVERLT nuk është e mjaftueshme. Hapa praktikë janë të nevojshëm për të inkurajuar dhe mundësuar përpjekjet e shoqërisë civile, duke filluar nga përfshirja në planifikimin strategjik, niveli i politikave për të mbështetur zhvillimin dhe zbatimin e programit. Nuk ekziston një kuadër ku „një masë për gjithçka» lidhur me angazhimin e shoqërisë civile në programet e P/CVERLT, ose me hartimin e ndërhyrjeve të udhëhequra nga shoqëria civile, ndërkohë që zhvillimi i zgjidhjeve vendore është kritik. Megjithatë, ekzistojnë sfida dhe faktorë të përbashkët që prekin pjesën më të madhe të konteksteve, të cilat duhet të shqyrtohen me kujdes.

## 5.1 Sfida kryesore

**Hapësira politike dhe ligjore** – Ekstremizmi i dhunshëm është një temë e ndjeshme, me implikime komplekse mbi sigurinë. Shoqëria civile dhe aktorët që kërkojnë të kontribuojnë në P/CVERLT jo gjithmonë pajisen me kontekstin e nevojshëm politik dhe ligjor për të punuar në mënyrë efektive. Disa OShC dhe ekspertë të fushës kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me atë që ata e konsiderojnë si kufizim të hapësirës për shoqërinë civile në emër të sigurisë, dhe luftës kundër terrorizmit<sup>71</sup>. Disa kufizime dhe pasoja ligjore gjatë punës me individët që përballen me ndjekje penale të lidhura me akuza për terrorizëm, ose që po vuajnë dënime si autorë të veprave të ekstremizmit të dhunshëm, janë të kuptueshme dhe të pashmangshme. Megjithatë, herë pas here, legjislacioni i gjerë kundër terrorizmit e bën të vështirë angazhimin e aktorëve të shoqërisë civile me individët më të rrezikuar nga radikalizmi terrorist, ose me individët që tashmë janë radikalizuar, për shkak të rrezikut të shënjestrimit si „mbështetës material“ ndaj terrorizmit<sup>72</sup>. Këto kufizime përfundojnë në reduktimin e formave të ndërhyrjes. Sa më shumë hiqen kufizimet dhe sa më të qarta dhe transparente bëhet kuadri ligjor dhe politik për angazhim të sigurt në hapësirën e P/CVERLT, aq më shumë gjasa ka që shoqëria civile dhe aktorët kryesorë të angazhohen më gjerësisht dhe fuqishëm.

**Përfshirja në nivelin strategjik dhe në nivelin e politikave** – Procesi i zhvillimit të strategjive P/CVERLT dhe i planeve përkatëse të veprimit ofron një mundësi unike për të nxitur përgjigje të përbashkët të qeverisë dhe gjithë shoqërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Ekspertët bien dakord se një proces gjithëpërfshirës është po aq i rëndësishëm sa vetë strategjia. Meqenëse ka shpesh kufizime të lidhura me kohën dhe me burimet sa i takon zhvillimit të dokumenteve të politikave, mund të ketë një tendencë „cut and paste“<sup>73</sup> ndaj ndërhyrjeve të rëndësishme. Kjo mund të sjellë përshtatjen e një terminologjie të mirëformuluar që përfshin qasjet që kanë funksionuar në kontekste të ndryshme, me nivele të ndryshme ekspertize dhe burimesh. Të njëjtat kufizime kohore mund ta kufizojnë nivelin e angazhimit me shoqërinë civile në konsultime sipërfaqësore, pas hartimit të projektstrategjisë. Kjo qasje *post-factum* asnjëherë nuk ka sjellë rezultate efektive.

Ekspertët në përgjithësi pajtohen në faktin se parakushti për një strategji efektive mbi P/CVERLT është përqafimi i një qasjeje thelbësore dhe gjithëpërfshirëse që integron aktorët e pavarur të shoqërisë civile, veçanërisht ato të përfaqësuara

71 Deklarata e Barcelonës: Plani i Masave të shoqërisë civile të Euro-Mesdheut për të parandaluar të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm (Observatori për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, 2017).

72 Komitetet të parat: Një gjurmë për organizimin dhe ruajtjen e një lëvizjeje globale kundër ekstremizmit të dhunshëm (Eric Rosand, Projekti i Parandalimit, 2016).

73 Të siguruarit e një qasjeje gjithëpërfshirëse për zhvillimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të veprimit P/CVE: Roli i shoqërisë civile (Projekti i Parandalimit, 2017).



më pak, si komponent thelbësor i procesit të hartimit. Përfshirja e OShC-ve të pavarura në fazën e zhvillimit të strategjisë jo vetëm që zgjeron grupin e ekspertizës dhe e bën procesin më përfaqësues, por krijon gjithashtu edhe një mundësi për angazhim kuptimplotë ndërmjet qeverisë dhe aktorëve vendorë. Zbatimi i suksesshëm i çdo strategjie P/CVERLT dhe ndikimi i ndërhyrjeve nga të dyja nivelet e qeverisjes dhe nga aktorët e shoqërisë civile do të përcaktohen në masë të madhe nga efektiviteti i partneriteteve të qëndrueshme të ndërtuara mbi besimin, vizionin e përbashkët dhe qëllimin e përbashkët.

**Financimi i përshtatshëm dhe i besueshëm** – P/CVERLT është një investim afatgjatë i orientuar drejt trajtimit proaktiv të pakënaqësive kronike që përpiqen të shfrytëzojnë organizatat e dhunshme ekstremiste. Ky është padyshim një proces kompleks që kërkon shumë pasion dhe përkushtim, sepse kërkon durim dhe mbështetje të besueshme në financim dhe burime të tjera. Sidoqoftë, specialistët në terren shpesh zbulojnë se as durimi dhe as financimi i donatorëve nuk janë të mjaftueshme në terren. Kjo manifestohet kryesisht nga natyra afatshkurtër e shumicës së afateve të financimit, ku OShC-të shpesh përballen me periudha tri deri në gjashtëmujore zbatimi për ndërhyrje që kërkon angazhim afatgjatë për të përcaktuar rëndësinë dhe autenticitetin në nivelin vendor dhe për të kapërcyer perceptimin se aktorët ndërkombëtarë i shohin jetët dhe komunitetet e individëve të prekur nga ekstremizmi si „projekte“<sup>74</sup>. Programet pilot janë të rëndësishme për testimin e qasjeve të reja dhe potencialisht të reja, megjithatë, ndikimi afatgjatë i tyre përcaktohet në mënyrë të pashmangshme nga disponueshmëria e burimeve pasuese.

Për më tepër, grupi i donatorëve që japin fonde për përpjekjet e komunitetit për P/CVERLT mbetet relativisht i kufizuar te donatorët e qeverive perëndimore dhe organizatat ndërkombëtare. Sektori privat, pavarësisht nga ndikimi negativ ekonomik i aktiviteteve terroriste, ende nuk ka treguar shenja mbështetjeje që shkojnë përtej gjesteve simbolike. Përrjashtim mund të jetë sektori i teknologjisë, ku kompanitë e mediave sociale po investojnë në mënyrë të vazhdueshme për parandalimin e përdorimit të platformave të tyre për radikalizim terrorist<sup>75</sup>. Përfshirja më e gjerë e shoqërisë civile në këto përpjekje mund të dëshmohet reciprokisht e dobishme.

**Mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve dhe pritshmëritë realiste** – Efektiviteti dhe qëndrueshmëria e ndikimit të përpjekjeve për P/CVERLT të udhëhequra nga shoqëria civile varen po aq nga financimi i besueshëm, sa edhe nga kapaciteti dhe përvoja e aktorëve zbatues. Në mënyrë të kuptueshme, donatorët ndërkombëtarë të përqendruar te shpërndarja e projekteve shpesh preferojnë

74 ICAN Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm, mbrojtja e të drejtave dhe policimi në komunitet: Pse është i rëndësishëm partneriteti midis shoqërisë civile dhe sektorit të sigurisë (2017).

75 Komunitetet të parat: Një gjurmë për organizimin dhe ruajtjen e një lëvizjeje globale kundër ekstremizmit të dhunshëm (Eric Rosand, Projekti i Parandalimit, 2016).

drejtimin e financimit për P/CVERLT tek një numër i vogël organizatash që kanë një historik të suksesshëm lidhur me përmbushjen e kërkesave të komplikuara për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të tilla<sup>76</sup>. Ndërkohë që kjo qasje mund të japë në fillim përshtypjen e përdorimit efikas të burimeve dhe mundësive të rezultateve të suksesshme, ajo, në mënyrë të tërthortë, i kufizon mundësitë për tërheqjen e aktorëve më pak të aftë dhe më pak të konsoliduar, për të ndërtuar ekspertizën e tyre dhe për të zgjeruar grupin e profesionistëve në terren për të ardhmen. Gjithashtu, kjo qasje mund të shpërfillë mundësinë që aktorët teknikisht më të konsoliduar nuk janë domosdoshmërisht ata që kanë besueshmërinë më të madhe ndërmjet komuniteteve të rrezikuara.

Ekspertët bien dakord se financimi për mbështetje në ndërtimin e kapaciteteve për partnerët vendorë, jo vetëm përmes trajnimit, por edhe përmes mundësive për t'u angazhuar në hartimin dhe zbatimin e projekteve, është drejtimi optimal i masave për rezultate të qëndrueshme. Kjo kërkon që donatorët të përdorin një qasje më pak të përqendruar te rreziku në raport me mbështetjen për grantmarrësit rishtarë, duke thjeshtuar procedurat e financimit dhe duke përshtatur pritshmëritë afatshkurtra për të marrë parasysh kufizimet e ekspertizës dhe kompleksitetin e realitetit ku veprojnë aktivistët e shoqërisë civile dhe ato të bazës. Me kalimin e kohës, kjo qasje përfshirëse e ndjekur nga përpjekjet e duhura për rritjen e kapaciteteve teknike ka të ngjarë të prodhojë një grup më të fuqishëm të aktorëve P/CVERLT më mirë të pozicionuar për të rritur në maksimum ndikimin e projekteve afatshkurtra të financuara nga donatorët.

**Shmangie nga instrumentalizimi** – Në një masë të konsiderueshme, suksesi i përpjekjeve për P/CVERLT varet nga krijimi i angazhimit kuptimplotë dhe partneriteteve transparente midis organeve të zbatimit të ligjit, udhëheqësve të komunitetit dhe aktorëve të shoqërisë civile. Këto partneritete funksionojnë më mirë kur ato janë bashkëpunuese. Ndërkohë që raportimi në kohë i veprimtarive të dyshimta terroriste dhe kërcënimeve të mundshme përbëjnë detyrë qytetare dhe detyrim ligjor për çdo qytetar, përpjekjet që përfshijnë shoqërinë civile rreth përqendrimit te grumbullimi i informacionit të klasifikuar penal dhe zbulimi i kërcënimeve janë shpesh bllokuese dhe mund ta dëmtojnë besueshmërinë e shoqërisë civile dhe të udhëheqësve të komunitetit në sytë e zonave të tyre zgjedhore<sup>77</sup>.

**Siguria dhe sigurimi personal** – Aktorët e shoqërisë civile që punojnë në fushën e P/CVERLT përballen me sfida të shumta, ku kërcënimet për sigurinë personale janë ndër më të rëndësishmet. Përmes angazhimit me individë që janë në rrugën e radikalizmit terrorist, ose që mund të kenë kryer vepra penale të lidhura me terrorizmin, aktivistët e shoqërisë civile dhe udhëheqësit e komuniteteve

76 Po aty.

77 Luftëtarët e huaj të kthyer dhe domosdoshmëria e riintegrit (Holmer and Shtuni, Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara, 2017).

ekspozohen ndaj rreziqeve të mëdha personale. Është e rëndësishme të kuptohet se hapësira ku ata angazhohen rrallë konsiderohet neutrale dhe shpesh është e polarizuar dhe e paqëndrueshme. Rrjetet e ekstremizmit të dhunshëm, përgjegjëse për rekrutimin dhe mobilizimin në organizata terroriste shpesh veprojnë në komunitete ose institucione të privimit të lirisë veçanërisht të cenueshme (si psh., burgjet). Qoftë përmes përballjes kundër narrativave të tyre, ose duke u përpjekur t'i tërheqin individët nga pikat e tyre të gravitetit, aktivistët e shoqërisë civile dhe udhëheqësit e komunitetit përballen dhe minojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë organizata veçanërisht të rrezikshme që kanë përqafuar dhunën si mjet të pranueshëm edhe në kontekstin civil. Llogaritja e përshtatshmërisë, kohës, nivelit dhe shtrirjes së angazhimit të shoqërisë civile në ndërhyrjet për P/CVERLT dhe marrja e masave për të zbutur rreziqet e sigurisë në bashkërendim me organizatat e zbatimit të ligjit është kritike<sup>78</sup>. Në raste të veçanta, madje, mund të jetë më mirë që të mos etiketohen specifikisht përpjekjet për P/CVERLT si të tilla, pasi kjo mund të jetë jo vetëm bllokuese/ frenuese, por edhe e pasigurtë.

**Dinamika vendore dhe ndjeshmëritë social-ekonomike** – Në botën e sotme të globalizuar dhe të ndërlidhur, ekstremizmi i dhunshëm është një fenomen gjithnjë e më kompleks, që vjen si pasojë e ndërveprimit dinamik midis faktorëve gjeopolitikë me një grupi shumë kontekstual të kushteve, ankesave dhe rrethanave vendore. Prandaj, trajtimi i manifestimeve vendore të ekstremizmit të dhunshëm kërkon si kuptimin e përgjithshëm të dimensionit të tij transnacional dhe të natyrës ideologjike, edhe vlerësimin objektiv dhe të nuancuar të shtytësve vendorë dhe dinamikë të radikalizmit terrorist. Në komunitetet me identitete shumë të politizuara etnike ose fetare që mund të kenë përjetuar diskriminim sektoral apo dhunë në të shkuarën, ekstremizmi i dhunshëm mund të shfaqet përgjatë ndasive politike, etnike ose fetare. Programet duhet të projektohen në mënyrë që ato të mos synojnë ose të stigmatizojnë grupe specifike, të mos rrisin polarizimin, ose të mos përkeqësojnë tensionet etnike.

**Monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të programit** – Matja dhe demonstrimi i efektivitetit dhe ndikimit programatik janë komponentë kritikë të çdo programi P/CVERLT. Kjo nuk bëhet vetëm për qëllimin e justifikimit dhe tërheqjes së fondeve, por, më e rëndësishmja, për vlerësimin e ndikimit. Në rastin e P/CVERLT, kjo është veçanërisht sfiduese për disa arsye. Së pari dhe mbi të gjitha, radikalizmi që çon në terrorizëm është një fenomen kompleks psikosocial që shkaktohet nga bashkëveprimi i faktorëve strukturorë dhe thellësisht individualë. Në iniciativat parandaluese «matja ose vlerësimi i së keqes» së VERLT nuk është vlerësuar saktësisht për shkak se pjesëmarrja e një individi në një program të caktuar parandalimi është e vështirë dhe e papërfunduar<sup>79</sup>.

78 Dhuna kundër ekstremizmit të dhunshëm: Perspektiva e ndërtimit të paqes (Holmer, USIP 2013).

79 Matja: Vlerësimi i programeve të ndikimit të P/CVE-së (Holmer, Bauman, Aryaenejad, USIP, gusht 2018).

Kjo është veçanërisht e vështirë për aktorët e shoqërisë civile dhe organizatat bazë që shpesh nuk kanë burime institucionale për të zhvilluar dhe/ose zbatuar metrika dhe metodologji rigorozë vlerësimi. Megjithatë, mund të jenë të dobishme disa praktika aktuale nga fushat e ndërtimit dhe zhvillimit të paqes për rritjen e mjeteve efektive të vlerësimit për programin e P/CVERLT. Disa nga këto praktika përfshijnë: zhvillimin e teorive të qarta të ndryshimit; mbledhjen e të dhënave përpara zbatimit të programit; ndjeshmërinë ndaj kontekstit; dhe integrimin e komponentëve sasiorë dhe cilësorë në procesin e vlerësimit<sup>80</sup>.

## 5.2 Udhëzime dhe praktika të mira në zhvillim

Më poshtë jepet një listë joshteruese e udhëzimeve dhe rekomandimeve që pasqyrojnë njohuritë aktuale mbi rolin që mund të luajë shoqëria civile për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm që çon në terrorizëm dhe mënyrat se si partnerët qeveritarë mund ta mbështesin këtë rol. Lista është produkt i analizës së literaturës dhe i analizës së burimeve të disponueshme për praktikën më të mira, të cilat përfshijnë praktikën e zhvilluar nga OSBE-ja, Kombet e Bashkuara, Forumi Global kundër Terrorizmit (GCTF), Shkëmbimi i Zgjidhjeve Globale (GSX) dhe Projekti i Parandalimit. Burime të tjera të përdorura janë hartuar nga Hedayah, Rrjeti Ndërkombëtar i Veprimit për Shoqërinë Civile (ICAN), Qendra Ndërkombëtare për Kundërterrorizmin (ICCT) dhe Instituti Mbretëror i Shërbimeve të Bashkuara (RUSI). Bibliografia përmban një listë gjithëpërfshirëse të burimeve të këshilluara në përgatitjen e këtij udhëzuesi.

- 1.** Iniciativat efektive për P/CVERLT të udhëhequr nga shoqëria civile kërkojnë një mjedis që u mundëson grupeve dhe aktorëve të shoqërisë civile të kryejnë punën e tyre pa ndërhyrje dhe në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, me të drejtën e mbledhjes dhe të organizimit. Kjo kërkon njohjen publike dhe politike të roleve të rëndësishme që mund të luhen nga një shoqëri civile e larmishme dhe e gjerë për parandalimin e VERLT.
- 2.** Partnerët e qeverisë duhet të lehtësojnë përfshirjen e shoqërisë civile në spektrin e plotë të programeve P/CVERLT dhe në zhvillimin e politikave. Duke krijuar partneritete dhe platforma për bashkëpunim, qeveritë mund të lehtësojnë ndërtimin e besimit me shoqërinë civile dhe të integrojnë më mirë përfshirjen e tyre në përpjekjet për P/CVERLT.

<sup>80</sup> Përmirësimi i ndikimit të programeve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm: instrument për projektimin, monitorimin dhe vlerësimin (UNDP dhe International Alert, mars 2018).

3. Angazhimi i rregullt me OShC-të mund të krijohet përmes mekanizmave të dakorduar, fleksibël dhe të përgjegjshëm të koordinimit me shumë agjenci, të tilla si:
- komitetet këshilluese të shoqërisë civile për të përfshirë më mirë kontributin e aktorëve të ndryshëm (duke përfshirë detajet e vyera të paralajmërimit të hershëm dhe shqetësimet dhe ankesat e komunitetit) në strategjinë dhe politikat P/CVERLT dhe në planifikimin e donatorëve;
  - qendrat e përqendruara në P/CVERLT, të cilat mbështesin dhe nxisin punën kërkimore ndërkombëtare, shkëmbimin e informacionit dhe shkëmbimin e praktikave të mira;
  - diskutime periodike në tryeza të rrumbullakëta dhe platforma të tjera për dialog dhe ushtrime për ndërtimin e besimit midis aktorëve të qeverisë dhe shoqërisë civile, për të përfshirë, kur është e mundur dhe sipas rastit, përfaqësuesit e organeve të zbatimit të ligjit;
  - aleancat institucionale me qeveritë e tjera, si dhe organizatat rajonale dhe shumëpalëshe, për të lehtësuar dialogun dhe për të koordinuar veprimet rreth çështjeve të P/CVERLT, si hartimi dhe zbatimi i përbashkët i planeve të veprimit dhe projektet e tjera bashkëpunuese.

### SHQIPËRIA: Krijimi i platformës së bashkëpunimit qeveri – shoqëri civile

Në dhjetor të vitit 2017, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë krijoi Qendrën e Bashkërendimit për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CCCVE), duke përmirësuar kuadrin ekzistues institucional për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (CVE) përmes transformimit të pozicionit të Koordinatorit Kombëtar për CVE në një platformë më të strukturuar. Misioni i kësaj strukture është zhvillimi i kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të angazhuar në P/CVERLT dhe promovimi i vlerave të tolerancës dhe përfshirjes. Ky është një mekanizëm premtues i udhëhequr nga qeveria, i projektuar për të siguruar një zbatim të koordinuar të Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit përkatës të Veprimit si dhe nxitjen e bashkëpunimit me aktorët e shoqërisë civile.

4. Aktorët qeveritarë duhet t'u bëjnë të mundur aktorëve dhe organizatave të besueshme të shoqërisë civile që të angazhohen për parandalim përmes vlerësimit dhe heqjes së pengesave ligjore, politike dhe logjistike gjatë operimit të tyre, në veçanti përmes:
  - a. lehtësimit në mënyrë aktive të punës së tyre dhe garantimit të sigurisë fizike (veçanërisht kur profesionistët e shoqërisë civile punojnë në hapësirat e kontestuara apo të populluara nga organizata ekstremiste të dhunshme), duke ofruar mbrojtje nga ngacmimet dhe kërcënimet, sigurinë e të dhënave, duke mundësuar aftësinë e tyre për t'u organizuar, lirinë e udhëtimit dhe pjesëmarrjen në konferenca/seminare (përfshirë edhe harmonizimin e proceseve të vizave) dhe pavarësinë nga ndërhyrja e qeverisë;
  - b. zbutjes së pengesave financiare (p.sh. financimin ndërkombëtar për luftën kundër terrorizmit dhe për politikat kundër pastrimit të parave) që mund të kenë ndikim mbi aksesin e shoqërisë civile në financimin e jashtëm dhe vetëfinancimin, duke penguar kështu vetëqëndrueshmërinë e tyre;

### Iniciativa e Liderëve të OSBE-së kundër Intolerancës dhe Ekstremizmit të Dhunshëm (LIVE): Ndërtimi i kapaciteteve të shoqërisë civile

LIVE është një program i OSBE-së i projektuar për të ndërtuar kapacitetet e shoqërisë civile për forcimin e fuqisë përballuese të komunitetit ndaj VERLT. Janë zhvilluar tri kurse intensive trajnimi për të rinjtë, gratë dhe udhëheqësit e komuniteteve në të gjithë zonën që mbulon OSBE-ja. Pjesëmarrësit janë përzgjedhur me kujdes për t'u siguruar që ata të jenë të angazhuar dhe të përkushtuar për paqen dhe tolerancën në komunitet. Gjatë kursit ata përmirësojnë aftësitë e tyre teknike në fusha kyçe, të tilla si të kuptuarit e duhur të medias, të menduarit kritik, ndikimi i politikave, komunikimet strategjike, hartimi dhe vlerësimi i projekteve dhe ndërgjegjësimi i sigurisë. Të informuar nga një sërë shembujsh praktikë, të pajisur me fonde fillestare dhe të mbështetur nga mentorë ekspertë, pjesëmarrësit kanë hartuar projekte origjinale, të rëndësishme dhe të përshtatshme të projektuara për të trajtuar dhe për t'iu përgjigjur shtytësve të VERLT në komunitetet e tyre.

- c. ofrimit të mbështetjes për rritjen e kapaciteteve (duke përfshirë përkthimin, botimin dhe/ose shpërndarjen e gjetjeve/ praktikave); promovimit të platformave për përfshirjen e disiplinave të tjera me rëndësi, të tilla si zhvillimi, parandalimi i konflikteve dhe ndërtimi i paqes; dhe përmes sigurimit të trajnimeve specifike mbi P/CVERLT për aktorët me përvojë të vyer në fusha të ngjashme, por me pak përvojë në hapësirën e parandalimit.
- 5.** Partneritetet ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe shoqërisë civile mund të forcohen dhe të kodifikohen përmes:
- a. qartësimin dhe përcaktimin të roleve dhe përgjegjësisë ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë/shoqërisë civile, me pritshmëri dhe rezultate specifike për të gjitha institucionet dhe aktorët pjesëmarrës;
  - b. trajnimit të zyrtarëve qeveritarë të vijës së parë për të punuar në bashkëpunim me aktorët joqeveritarë për ndërtimin e kapaciteteve përkatëse për P/CVERLT;
  - c. njohjes së komponentëve të programeve P/CVERLT të cilat më mirë t'u lihen në dorë aktorëve të shoqërisë civile, duke ua dhënë përgjegjësitë për këto iniciativa këtyre palëve të interesit pa ndërhyrje ose pa manipulime nga qeveria.
- 6.** Aktorët qeveritarë dhe aktorët e konsoliduar joqeveritarë duhet të përpiqen të angazhohen, të ndërtojnë kapacitete dhe të fuqizojnë zërat e aktorëve më të vegjël dhe më pak të njohur të shoqërisë civile me përvojën e duhur, me besueshmëri dhe efikasitet, veçanërisht të atyre që punojnë në vende kyçe gjeografike, me demografi me dobësi të njohura. Duhet pranuar që partnerët që potencialisht me efekt, lokalë, jo të dhunshëm të shoqërisë civile, mund të mos kenë vizibilitet dhe përvojë të dokumentuar me të punuarit përkrah qeverisë dhe, në të vërtetë, mund të mos pajtohen me aspekte të pozicioneve zyrtare të qeverisë mbi çështjet e sigurisë dhe çështje të tjera, por, pavarësisht kësaj, mund të shërbejnë si partnerë produktivë. Aktorët e qeverisë duhet të përpiqen t'i gjejnë dhe t'i angazhojnë këta aktorë/organizata më shumë se sa aktorët/organizatat që thjesht hiqen si «miqësore me qeverinë».
- 7.** Përdorimi i gjuhës së “sigurimit” dhe terminologjia e P/CVERLT mund të jetë problematike për disa aktorë të shoqërisë civile, mund të rrezikojë besueshmërinë vendore dhe sigurinë fizike të tyre. Prandaj, qeveritë duhet të përmirësojnë gjuhën për të shmangur tjetërsimin e partnerëve të mundshëm.

8. Zhvillimi dhe ruajtja e rrjeteve vendore dhe rajonale të pavarura ndërmjet shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë joqeveritarë të P/CVERLT mund të ofrojë mundësi për rritje dhe bashkëpunim. Për të inkurajuar këto përpjekje:
- duhen zhvilluar koalicione vendore të aktorëve dhe organizatave të shoqërisë civile të përqendruara në P/CVERLT, të cilat punojnë drejtpërdrejt me komunitetet dhe familjet;
  - duhen përfshirë aktorët e shoqërisë civile nga disiplina të lidhura, siç janë: transformimi i konflikteve; ndërtimi i paqes; qeverisja e mirë; zhvillimi; pjesëmarrja politike; dialogu ndërfaqësor dhe ndërkomunitar; të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e grave; veprimtaritë rinore; dhe fusha të tjera të tjera të lidhura me P/CVERLT;
  - duhen përfshirë profesionistë nga sektorë të tjerë, si shëndeti mendor, e drejta dhe puna sociale, si dhe akademikë me përvojë praktike dhe duhet nxitur shkëmbim kuptimplotë dhe i qëndrueshëm me aktorët e shoqërisë civile dhe politikëbërësit.

### MALI I ZI:

#### Ndërtimi i një rrjeti rajonal të shoqërisë civile

“Komunitetet të parat” është një platformë rajonale e shoqërisë civile e Ballkanit Perëndimor e dedikuar për P/CVERLT, e drejtuar nga një organizatë joqeveritare (OJQ) në Malin e Zi, Forumi MNE. Kjo nismë trivjeçare, e mbështetur nga Komisioni Evropian, përfshin organizatat e shoqërisë civile (OShC) nga të gjitha vendet e rajonit dhe është e përqendruar në nxitjen e bashkëpunimit rajonal midis OShC-ve dhe aktivistëve të komunitetit të përfshirë në P/CVERLT. Qëllimi i nismës “Komunitetet të parat” është të fuqizojë aktorët e shoqërisë civile, duke përfshirë të rinjtë, gratë dhe organizatat fetare, për të rritur kapacitetin e tyre, për të përmirësuar efikasitetin dhe llogaridhënien e tyre, dhe për të ushtruar ndikim më efektiv mbi politikën përkatëse të P/CVERLT. Aktivitetet përfshijnë: hartëzimin e programeve P/CVERLT të udhëhequra nga OShC-të në rajon; përgatitjen e një faqeje interneti interaktive për ndarjen e praktikave të mira; organizimin e seminareve për ndërtimin e kapaciteteve dhe programet e mentorimit; si edhe krijimin dhe zbatimin e programeve të granteve të vogla.



9. Të kuptuarit e iniciativave në nivel komuniteti si strategji afatgjata, të qëndrueshme dhe që mund të përshtaten, më shumë se sa si projekte të izoluara. Politikëbërësit dhe donatorët përkatës mund të sigurojnë përdorim efektiv të financimeve përmes:
  - a. lejimit të fleksibilitetit lidhur me afatet e financimit për të mbuluar proceset që kërkojnë kohë, të tilla si ndërtimi i vizibilitetit dhe besimit, kryerja e studimeve kërkimore dhe vlerësimeve, kryerja e monitorimit dhe vlerësimit, dhe tolerimi i dështimeve afatshkurtra;
  - b. sigurimit të financimeve pasuese në kuadrin afatmesëm deri në afatgjatë për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe rritjen e profilit të projekteve me sukses të demonstruar;
  - c. sigurimit të fondeve bazë, krahas financimeve të bazuara në projekte, me qëllim fuqizimin e shoqërisë civile për të përcaktuar prioritetet e tyre, përqëndrimin te misionet kryesore dhe rritjen në mënyrë strukturore për të siguruar qëndrueshmëri në kuadrin më afatgjatë;
  - d. sigurimit të kërkimeve dhe analizave të pavarura, të bazuara te të dhëna që mbështesin programet P/CVERLT dhe jo te konkluzionet intuitive mbi çfarë mund “të funksionojë”;
  - e. përfshirjes së përfaqësuesve të donatorëve lokalë në të gjitha fazat e programeve P/CVERLT për të siguruar komunikimin ndërmjet donatorëve dhe zbatuesve;
  - f. balancimin e bindjes së nevojshme nga qeveria për iniciativat P/CVERLT të mbështetura nga donatorët, me prioritetin e mbështetjes së bashkëbiseduesve me besueshmërinë dhe ndikimin më të madh në komunitetet e marginalizuara.
10. Theksimi i rëndësisë së ndërtimit të kapaciteteve lokale për hulumtime sasiore dhe cilësore në lidhje me tendencat rajonale dhe demografike mbi aktivitetin e ekstremizmit të dhunshëm. Krijimi i lidhjeve të shoqërisë civile me kërkuesit akademikë dhe partnerë të tjerë përkatës kur është e dobishme dhe inkurajimi i zhvillimit të platformave dhe rrjeteve për të lehtësuar shpërndarjen e gjetjeve të kërkimeve.

## SERBIA:

### Mbështetja për studimet kërkimore vendore

Misioni i OSBE-së në Serbi po mbështet hulumtimet e pavarura akademike mbi temat që lidhen me VERLT në Serbi, në mënyrë që të kontribuojë në literaturë, të mbështesë programet dhe hartimin e politikave të bazuara në të dhëna dhe të forcojnë numrin e studiuesve që punojnë mbi këtë temë. Disa kohë më parë u çel një thirrje për propozime për të thithur një gamë të gjerë idesh për hulumtime dhe cilësia e propozimeve tregoi se studiuesit, veçanërisht studiuesit serbë të cilët e njohin mirë mjedisin e brendshëm, kanë një kuptim të fortë, të nuancuar dhe të sofistikuar të natyrës së ekstremizmit në vend. Janë mbështetur nëntë iniciativa hulumtuese, si edhe është siguruar një proces i strukturuar rishikimi nga kolegët, në mënyrë që çdo autor të marrë komente rigoroze.

11. Për angazhimin e aktorëve dhe organizatave të shoqërisë civile, politikëbërësit duhet të njohin rolin kritik të rinisë si agjent pozitiv ndryshimi. Ato duhet të përpiqen të theksojnë dhe të integrojnë përfshirjen e tyre, veçanërisht të rinjve nga komunitetet e marginalizuara, në vendimmarrjen përkatëse për çështje të P/CVERLT kurdo që është e mundur. Në partneritet me aktorët dhe organizatat e shoqërisë civile, politikëbërësit duhet të ndërtojnë kapacitetet dhe të rrisin përpjekjet e iniciativave të përqendruara te të rinjtë. Në veçanti, duhet të mbështeten programet që nxisin fuqizimin dhe aftësitë e lidhura me leadershipin, komunikimin dhe sipërmarrjen. Duhet t'i kushtohet vëmendje sigurimit të fondeve për grantet e vogla, në bashkëpunim me sektorin e biznesit, aty ku është e mundur, për iniciativat e komunitetit për P/CVERLT të drejtuara nga të rinjtë, veçanërisht për ato iniciativa që synojnë grupet dhe komunitetet e marginalizuara.
12. Zbatimi i projekteve dhe iniciativave të përqendruara te të rinjtë përmes OShC-ve dhe, kur është me vend, përmes partneriteteve të sektorit privat dhe publik, të cilat synojnë:
  - a. t'u ofrojnë të rinjve hapësira të sigurta dhe të pakontrolluara, ku mund të ngrenë shqetësime në mënyrë proaktive, të diskutojnë dhe të debatojnë çështje që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe çështje të tjera shoqërore dhe politike, edhe nëse ato kanë natyrë të diskutueshme;

- b. të inkurajojë angazhimin qytetar dhe demokratik të të rinjve për të ofruar kanale pozitive për trajtimin e ankesave dhe për të themeluar këshillimin e të rinjve dhe mekanizma të ngjashëm për të siguruar dëgjimin e zërave të tyre në të gjitha nivelet;
- c. të ofrojnë mbështetje strukturore për të rinjtë, veçanërisht për ata që përballen me diskriminim në komunitetet e marginalizuara, siç janë mundësitë për punësim dhe këshillim, akses në shërbimet shëndetësore dhe sociale, dhe mbështetje dhe këshillimi psikosocial;
- d. të promovojnë përfshirjen në sport, art dhe alternativa të tjera për kohën e lirë, të cilat nxisin ndjenjën e përgjegjshmërisë komunitare dhe përfshirjen sociale;
- e. të nxisin besimin në nivelin vendor midis vendimmarrësve dhe grave të reja dhe burrave, veçanërisht midis personave nga grupet më pak të përfaqësuara, përmes dialogut ndërmjet brezave dhe aktiviteteve për ndërtimin e besimit dhe trajnim si pjesë e programeve kurrikulare;

### **BOSNJA dhe HERCEGOVINA: Mbështetje për programet rinore dhe artet**

Në vitin 2018, Misioni i OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë udhëhoqi një iniciativë dhe konkurs për të rinjtë që i përdornin artet dramatike si mjet komunikimi efektiv për sensibilizimin e publikut ndaj problemit të ekstremizmit të dhunshëm. U përzgjodhën përafërsisht 30 studentë universiteti për të marrë pjesë në dy seminare të organizuara në Sarajevë dhe Banja Luka. Nën udhëheqjen e profesorëve të artit dramatik, gjatë dhe pas seminareve, studentët hartuan skenare dhe zhvilluan shfaqje që eksploronin udhëtime të ndryshme përgjatë rrugës së radikalizmit në ekstremizëm të dhunshëm. Procesi krijues i studentëve u mbështet gjithashtu nga puna kërkimore mbi temat e krimeve të urrejtjes dhe incidentet e motivuara nga paragjykimet, si dhe në aspektet psikologjike të radikalizimit në ekstremizëm të dhunshëm etj. Konkursin e fituan katër grupe studentësh nga Universitetet e Sarajevës dhe Banja Lukës, si dhe nga Shkolla e Shkencës dhe Teknologjisë e Sarajevës. Ata i shfaqën pjesët përkatëse para një auditori gjatë një aktiviteti të organizuar nga Misioni i OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë në fillim të vitit 2018.

ashtu edhe në ato pas shkolle. Edukatorët, ashtu si edhe udhëheqësit fetarë dhe komuniteti, mund të luajnë rol të rëndësishëm për lehtësimin e iniciativave të tilla.

**13.** Përfshirja e autoriteteve arsimore në të gjitha nivelet e dialogut mbi P/CVERLT dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për të planifikuar dhe zbatuar programet përkatëse në bashkëpunim me palët e interesuara të shoqërisë civile. Nismat që mund të prodhohen si rezultat mund të përfshijnë:

- a. reformimin e kurrikulave shkollore për të pasqyruar praktikat më të mira për integrimin e komuniteteve të reja minoritare/migruese, që synojnë reduktimin e perceptimeve të marginalizimit dhe diskriminimit;
- b. fuqizimin e të rinjve për të krijuar iniciativa të reja (dhe për të shpërndarë iniciativat ekzistuese), mesazhe alternative pozitive dhe kundërnarrativa, të cilat ndihmojnë shkëputjen, diskreditimin dhe rrëzimin e ideve për ekstremizëm të dhunshëm;
- c. zbatimin e programeve të edukimit për sigurinë në internet dhe programeve të edukimit mbi median për t'i mësuar studentët të njohin dhe të refuzojnë narrativa të ekstremizmit të dhunshme, duke promovuar narrativat e bazuara te të drejtat e njeriut, toleranca dhe vlerat demokratike.

**14.** Politikëbërësit duhet gjithashtu të njohin rolin e grave dhe vajzave si aktore kryesore dhe agjente të ndryshimit pozitiv në programet e P/CVERLT dhe të theksojnë përfshirjen e grave (dhe OShC-ve të përqendruara te gratë) në të gjitha fazat dhe nivelet e vendimmarrjes mbi P/CVERLT. Në partneritet me OShC-të, politikëbërësit:

- a. duhet të ndërtojnë kapacitetet dhe të mbështesin pronësinë vendore të OShC-ve të udhëhequra nga gratë dhe të përqendruara te gratë, të tilla si OShC-të që punojnë në fushën e të drejtave të grave, të angazhohen në përpjekjet parandaluese dhe përgjigjet ndaj ekstremizmit të dhunshëm, të përshtatura specifikisht me kontekstin ku punojnë. Politikëbërësit duhet të sigurohen që këto grupe të kenë akses në burime dhe siguri fizike dhe që zërat e tyre të dëgjohen në qarqet e politikëbërjes në të gjitha nivelet;
- b. duhet të sigurohen që politikat dhe programet e P/CVERLT të shqyrtojnë dhe trajtojnë perspektivat gjinore në VERLT dhe të synojnë të parandalojnë dhe trajtojnë ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit mbi gratë dhe vajzat. Gratë dhe vajzat kanë role unike në ekstremizmin e dhunshëm, kështu që

politikëbërësit duhet të investojnë në studime në nivel vendor për të kuptuar më mirë dinamikat përkatëse të komunitetit;

- c. duhet të mbështesin trajnimin e grave, veçanërisht brenda hapësirave të pranueshme dhe të sigurta shoqërore, për t'i fuqizuar ato për të njohur dhe t'iu përgjigjur VERLT nga pozicionimi unik dhe i fuqishëm i të qenit nëna, gra dhe figura të komunitetit; gratë mund të kenë kapacitet për t'u përfshirë në paralajmërimin e hershëm, por nuk kanë ende mjetet apo mbështetjen e nevojshme për t'u përfshirë në këtë aspekt;
- d. duhet të përfshijë burrat dhe djemtë në përpjekjet për integrimin gjinor. Si burime ndikimi në komunitete dhe familje, burrat mund të ndihmojnë për formulimin e narrativave kulturore, koncepteve të maskulinitetit dhe kundërpërgjigjeve ndaj ideologjisë së dhunshme ekstremiste dhe janë partnerë kritikë në programet e mbështetura te familjet;
- e. duhet të sigurohen që programet me kundërpërgjigje/alternativa të përfshihen në çështjet gjinore, veçanërisht nëpërmjet përfshirjes së OShC-ve në përgjithësi dhe OShC-ve që kanë gratë në qendër të vëmendjes në veçanti në zhvillimin dhe shpërndarjen e iniciativave me mesazhe të duhura dhe në mënyrë specifike të trajtojnë rolin e grave si grupe interesi në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

### Ish-Republika Jugosllave e Republikës së Maqedonisë: Zbatimi i programeve të përqendruara te gratë

Modeli “Shkolla e Nënave” është projektuar dhe çuar përpara nga organizatat joqeveritare (OJQ) Gratë pa Kufij si një qasje novative dhe konstruktive për ndërtimin e kapacitetit të nënave për të kuptuar, për të njohur dhe zbutur shenjat e hershme të cënueshmërisë ndaj radikalizimit të fëmijët e tyre. Modeli është zbatuar me sukses në më shumë se dhjetë vende gjatë dekadës së fundit dhe në vitin 2017 është shtrirë me partnerët vendorë në Shkup. Programi jo vetëm që ndërton vetëbesimin e pjesëmarrësve dhe përmirëson aftësitë prindërore të tyre, por krijon gjithashtu edhe një hapësirë të sigurt dhe mbështetëse për gratë për të diskutuar hapur dhe për të trajtuar çështje të ndjeshme.

- 15.** Komuniteti me influencë dhe i shquar dhe udhëheqësit fetarë kanë njohuri të thella dhe akses të posaçëm në komunitetet e tyre. Politikëbërësit, në bashkëpunim me aktorët dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të përpiqen të angazhojnë figura të tilla si partnerë kritikë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Ata:
- a. duhet të rrisin ndërgjegjësimin mbi P/CVERT ndërmjet udhëheqësve fetarë dhe komunitetit (sidomos për këshilltaret shpirtërore femra, të cilat mund të kenë akses unik te gratë në komunitetet e cënueshme), duke i inkurajuar ato që të ofrojnë udhëzime për komunitetet dhe familjet për të rritur rezistencën ndaj VERLT;
  - b. duhet të fuqizojnë udhëheqësit fetarë dhe udhëheqësit e komunitetit për të siguruar platforma (të tilla si shkëmbimet për teologët e rinj) për dialogun fetar dhe dialogun ndërfitar për të nxitur tolerancën dhe mirëkuptimin ndërfitar dhe për të zgjidhur dallimet kur ato ekzistojnë; ata duhet të nxisin dialogun dhe bashkëpunimin midis rrjeteve vendore ndërfitare, duhet të diskutojnë çështjet që lidhen me P/CVERLT dhe të promovojnë përfshirjen e të gjitha besimeve;
  - c. kur është e mundur, duhet t'i inkurajojnë udhëheqësit përkatës fetarë dhe të komunitetit për të promovuar ndërtimin e besimit dhe bashkëpunimin mes familjeve dhe autoriteteve vendore; ky bashkëpunim duhet të strukturohet në bazë të sigurisë së komunitetit në mënyrë që të shmanget «instrumentalizimi» i marrëdhënieve me udhëheqësit e komunitetit, dhe potencialisht t'i tjetërsojë komunitetet përkatëse;
  - d. duhet të nxisin partnerët përkatës qeveritarë dhe shoqërinë civile për t'u ofruar udhëheqësve fetarë trajnime për zgjidhjen e konflikteve dhe mbi strategjitë e komunikimit për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe ideologjitë ekstremiste të dhunshme dhe të trajtojnë mosmarrëveshjet në nivel komuniteti/nivel individual;
  - e. duhet të inkurajojnë liderët fetarë të transmetojnë tregime jo të dhunshme për të dëbuar ekstremistët e dhunshëm, veçanërisht në bashkëpunim me fushatat mediatike mbi P/CVERLT, të udhëhequra nga shoqëria civile;
  - f. duhet të përfshijnë udhëheqësit fetarë dhe individë të tjerë nga komuniteti në iniciativat e ndërtimit të besimit të qeverisë dhe komunitetit, siç janë diskutimet periodike në tryeza të rrumbullakëta, për të nxitur bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe zhvillimin e kapaciteteve.

## KOSOVA<sup>81</sup>: Angazhimi i udhëheqësve fetarë dhe i të rinjve në dialogun ndërfaqetarak

Në nëntor të vitit 2017, Misioni i OSBE-së në Kosovë mori 50 nxënës shqiptarë të shkollave të mesme të Kosovës nga komuna e Kaçanikut për një turne në objektet e rëndësishme fetare në qytetin historik të Prizrenit. Shtëpia e disa monumenteve kulturore më mirë të ruajtura që i përkasin qytetërimeve dhe feve të ndryshme, Prizreni është një metaforë e gjallë e diversitetit dhe harmonisë fetare. Së bashku me një grup prej 25 të rinjsh nga komunitetet etnikisht të ndryshme në Prizren, të rinjtë nga Kaçaniku u bashkuan në një diskutim me përfaqësuesit e Komunitetit Islam, Kishës Ortodokse Serbe, Kishës Katolike, Sufit Halvet, Komunitetit Hebre dhe Kishës Protestante si edhe me Zëvendësministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve të programit nga Kaçaniku nuk i kishin vizituar asnjëherë vendet e adhurimit që u përkisnin feve të tjera, ose nuk kishin ndërvëpruar asnjëherë me një udhëheqës fetar të ndryshëm nga udhëheqësi fetar i fesë së tyre. Kjo bisedë u dha atyre një mundësi të vyer për të mësuar më shumë për fqinjët dhe njerëzit e tjerë në komunitet dhe për të zgjeruar botëkuptimin mbi trashëgiminë kulturore dhe fetare të vendit. Projekte të tjera që janë përqendruar te promovimi i dialogut ndërfaqetarak dhe respektimi i diversitetit gjatë viteve, një fushë kyçe e punës për OSBE-në në Ballkan, përfshijnë vizita studimore në vendet historike dhe fetare, një kamp rinor ndërfaqetarak dhe një tur basketbolli për të rinjtë.

16. Sektori privat, duke përfshirë donatorët nga korporatat dhe privatët, si dhe bizneset e mëdha dhe të vogla, mund të shërbejnë gjithashtu si palë konstruktive në programet e P/CVERLT. Për të shfrytëzuar përparësitë e tyre krahasuese, politikëbërësit:
  - a. duhet të inkurajojnë investimet e korporatave/private, në bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe përpjekjet e komunitetit për P/CVERLT, aty ku është e përshtatshme. Projektet e përgjegjesisë sociale të korporatave,

81 Të gjitha referencat ndaj Kosovës në këtë tekst, qoftë ndaj territorit, institucioneve ose popullsisë së saj duhet të kuptohen në përputhshmëri të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

përvoja në markim dhe ekspertizë dhe filantropia private mund të mobilizohen në mënyrë efektive dhe shpejt për të mbështetur iniciativat e P/CVERLT, të cilat ndryshe mund të përballen me pengesa burokratike kur bëhet fjalë për sponsorë qeveritarë;

- b. duhet të miratojnë qasjen e shoqërisë “si një e tërë” për mesazhet *online* dhe *offline*, veçanërisht duke shfrytëzuar sektorin e teknologjive të komunikimit të informacionit në bashkëpunim me dhe të informuar nga aktorë të tjerë përkatës të shoqërisë civile.
- 17.** Mediat mund të ftohen dhe të inkurajohen për të çuar më parë qëllimet e P/CVERLT duke fuqizuar zërin e komunitetit dhe duke raportuar me përgjegjësi për ngjarjet që lidhen me terrorizmin. Për të rritur aftësitë e tyre, politikëbërësit:
- a. duhet të inkurajojnë dhe të mbështesin platformat e mediave profesionale dhe të mediave sociale për të luajtur një rol të përgjegjshëm dhe konstruktiv në P/CVERLT, në konsultim me komunitetet (dhe sidomos për lajmëtarët e tyre më efektivë dhe me ndikim) dhe partnerët qeveritarë/ joqeveritarë;
  - b. duhet të fuqizojnë mediat përmes televizionit, radios dhe përpjekjeve *online*, të shpërndajnë mesazhe pozitive të udhëhequra nga komuniteti, si dhe të mbështesin dhe të rrisin vizibilitetin e iniciativave vendore për P/CVERLT;
  - c. duhet të angazhohen mediat dhe të ofrojnë trajnime për gazetarët, sipas nevojës, për të inkurajuar raportimin objektiv për ngjarjet e ekstremizmit të dhunshëm; duhet të promovojnë tolerancën dhe respektin për të gjitha kulturat; dhe të sigurojnë raportime të dukshme mbi narrativat e angazhimit pozitiv me të rinjtë dhe iniciativat e udhëhequra nga komuniteti.



## Fushata e OSBE-së #Të bashkuar kundër CVE: Përdorimi i medias sociale për promovimin e alternativave ndaj VERLT

OSBE prezantoi në vitin 2015 fushatën e komunikimit strategjik #UnitedCVE (#Të bashkuar kundër CVE) për të ndihmuar në nxitjen e një komuniteti online të të rinjve, profesionistëve, politikbërësve dhe kërkuesve për të sfiduar intolerancën dhe ekstremizmin e dhunshëm dhe për të përforcuar përpjekjet për parandalim dhe ndërgjegjësim. Si pjesë e fushatës u prezantuan mbi 40 video të shkurtra me praktika vendore të P/CVERLT në zonën e mbuluar nga OSBE-ja, ku u theksuan veçanërisht projektet dhe nismat e udhëhequra nga të rinjtë. Fushata numëron mbi 44 milionë njerëz në platformat kryesore të mediave sociale, duke përfshirë Twitter-in, Instagram-in dhe Facebook-un.





# 6. Përfundime



Kuptimi i rolit të vyer të shoqërisë civile për parandalimin dhe luftën kundër VERLT është hapi i parë i rëndësishëm drejt zhvillimit të strategjive holistike dhe gjithëpërfshirëse për të trajtuar kërcënimet e sigurisë të shkaktuara nga ekstremizmi i dhunshëm. Ky udhëzues është hartuar për të çuar këto ide përpara dhe për të dhënë sugjerime dhe shembuj konkretë për krijimin e marrëdhënieve produktive të punës ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe shoqërisë civile dhe për zhvillimin e programeve P/CVERLT me ndikim dhe të bazuara në komunitet. Është e rëndësishme që shoqërisë civile t'i jepet hapësirë ligjore, mbështetje politike, burime financiare dhe udhëzime praktike për të qenë e suksesshme në punën e saj dhe që roli i saj të shihet si thelbësor në promovimin e paqes dhe sigurisë. Programet e P/CVERLT janë përpjekje afatgjata dhe komplekse. Suksesi i tyre varet në masë të madhe nga promovimi i vazhdueshëm i praktikave të mira dhe shkëmbimi i mësimave të nxjerra dhe burimeve në kontekste të ndryshme. Udhëzuesi synon të kontribuojë në këtë diskurs dhe nënvizon angazhimin e OSBE-së për të mbështetur rolin që mund të luajë dhe që luan shoqëria civile për t'i bërë komunitetet më të sigurta dhe më rezistente.



# Burime të përzgjedhura të OSBE-së

Chairmanship's Perception Paper: Recommendations from the 2017 OSCE-wide Counter-Terrorism Conference on 'Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism' (May 2017)

Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: Ideas, Recommendations, and Good Practices from the OSCE Region (Peter Neumann, OSCE, 2017)

Ministerial Council Declaration on Strengthening OSCE Efforts to Prevent and Counter-Terrorism (MC.DOC/1/16)

Ministerial Council Declaration on Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism (MC.DOC/4/15)

Ministerial Council Declaration on Reinforcing OSCE Counter-Terrorism Efforts in the Wake of Recent Terrorist Attacks (MC.DOC/3/15)

Ministerial Council Declaration on the OSCE Role in Countering the Phenomenon of Foreign Terrorist Fighters in the Context of the Implementation of United Nations Security Council Resolution 2170 (2014) and 2178 (2014) (MC.DOC/5/14)

Ministerial Council Declaration on Strengthening Co-ordination and Coherence in the OSCE's Efforts to Address Transnational Threats (OSCE, MC.DEC/9/11)

Consolidated Reference for OSCE Anti-terrorism Efforts

Overview of OSCE Counter-terrorism-related Commitments

Factsheet of the OSCE Action against Terrorism Unit

OSCE Parliamentary Assembly Berlin Declaration: Resolution on Preventing and Countering Terrorism and Radicalization and Violent Extremism that Lead to Terrorism (2018)

OSCE Parliamentary Assembly Resolution on Strengthening the Role of Civil Society in the OSCE Region (Istanbul Declaration 2013)

Preventing Terrorism and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: A Community-Policing Approach (OSCE and ODIHR, 2014)

Security Days: Building bridges - promoting dialogue to prevent radicalization and violent extremism (OSCE, 2015)

The Role of Civil Society in Preventing Terrorism (ODIHR 2007)

“Youth and the Prevention of Violent Extremism” Workshops in Western Europe, Black Sea region, South-Eastern Europe, North Africa and Central Asia – Recommendations for Policy Makers (OSCE, 2017)

Youth Engagement to Counter Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: Report on findings and recommendations (OSCE Secretariat and ODIHR, 2012)

Women and Terrorist Radicalization Final Report (OSCE Secretariat and ODIHR Expert Roundtables, 2011)

Workshop Recommendations on Supporting Civil Society Initiatives to Empower Women’s Roles in Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism (OSCE and GCTF, 2015)

# Bibliografia

Beutel, A., START, From WWI to ISIS, Using Shame and Masculinity in Recruitment Narratives (2016)

Center for Strategic and International Studies, Concept and Definition of Civil Society Sustainability (2017) for strategy development (2000)

Centre for Civil Society, London School of Economics and Political Science, Report on Activities (July 2005–August 2006)

Centre for Strategic and International Studies (CSIS), Turning Point: A new comprehensive strategy for countering violent extremism (November 2016)

Centre on Global Counter-terrorism Co-operation, Mightier than the sword? The role of the media in addressing violence and terrorism in South Asia (2013)

Cortright et al., Friend Not Foe: Opening spaces for civil society engagement to prevent violent extremism (2011)

Council of Europe Presidency, Revised EU Strategy for Combating Radicalization and Recruitment to Terrorism (2014)

Council of the European Union, Council Conclusions on EU External Action on Counter-Terrorism, General Secretariat of the Council (19 June 2017)

Eisenman, D.P. and Flavahan, L. Canaries in the coal mine: Interpersonal violence, gang violence, and violent extremism through a public health prevention lens (2017)

EPRD Policy & Development, Mapping Study of Civil Society Organizations in BIH (2016)

Global Center on Cooperative Security, Going Local: Supporting Community-Based Initiatives to Prevent and Counter Violent Extremism in South and Central Asia (2017)

Global Counterterrorism Forum, Ankara Memorandum on Good Practices for a Multi-Sectoral Approach to Countering Violent Extremism (2013)

Global Counterterrorism Forum, Good Practices on Community Engagement and Community-Oriented Policing as Tools to Counter Violent Extremism (2013)

Global Counterterrorism Forum, Good Practices on Women and Countering Violent Extremism (2015)

Global Counterterrorism Forum, Marrakech Memorandum on Good Practices for a More Effective Response to the FTF Phenomenon (2014)

Global Counterterrorism Forum, Rome Memorandum on Good Practices for Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders (2012)

Global Counterterrorism Forum, The Role of Families in Preventing and Countering Violent Extremism: Strategic recommendations and programming options (2016)

Global Counterterrorism Forum, Zurich-London Recommendations on Preventing and Countering Violent Extremism and Terrorism Online (2017)

Global Solutions Exchange, 10 Reasons Why Civil Society is an Ally and Not an Adversary in the Struggle against Violent Extremism (2017)

Global Solutions Exchange, Improving PVE Practice: 10 Steps to Designing and Implementing Inclusive National Action Plans to Prevent Violent Extremism (2018)

Global Solutions Exchange, Innovations in Civil Society and Other Locally-Led Efforts to Prevent Violent Extremism (2017)

Global Solutions Exchange, Recommendations on Donor Engagement with Civil Society on Preventing Violent Extremism (2017)

Global Solutions Exchange, Improving PVE Practice: 10 Steps to Strengthening Rehabilitation and Reintegration Efforts for Terrorism Offenders, Returning Foreign Terrorist Fighters, and Victims of Violent Extremism (2017)

Hedayah and the Global Center on Cooperative Security, A Man's World? Exploring the roles of women in countering terrorism and violent extremism (2016)

Hedayah Center, Guidelines and Good Practices: Developing National P/CVE Strategies and Action Plans (2016)

Holmer, G. United States Institute of Peace (USIP), Countering violent extremism: A peacebuilding perspective (2013)

Holmer, G. and Shtuni, A., United States Institute of Peace (USIP), Returning Foreign Fighters and the Reintegration Imperative (2017)

Idris, I. and Abdelaziz, A., GSDRC, Women and Countering Violent Extremism (2017)

International Civil Society Action Network (ICAN), Preventing Violent Extremism, Protecting Rights and Community Policing: Why civil society and security sector partnerships matter (2017)

International Criminal Court, *Engaging Civil Society in Countering Violent Extremism: Experiences with the United Nations Global Counter-Terrorism Strategy* (The Hague, 2012)

Kosovo Civil Society Foundation, “Monitoring Matrix on enabling environment for civil society development” (2016)

Mandaville, P. and Nozell, M., United States Institute of Peace (USIP), *Engaging Religion and Religious Actors in Countering Violent Extremism* (2017)

National Security Preparedness Group, Bipartisan Policy Center, *Preventing Violent Radicalization in America* (2011)

*New Perspectives on South-Eastern Europe, Civil Society and Transitions in the Western Balkans* (2013)

Observatory to Prevent Extremist Violence, *Barcelona Declaration – Plan of Action of the Euro-Mediterranean civil society to prevent all forms of violent extremism* (2017)

Office of the Special Adviser on Gender Issues and Advancement of Women, UN Women, *Gender mainstreaming: Strategy for promoting gender equality* (2001)

OSCE and The Prevention Project, *Civil Society Day – OSCE-wide Counter-Terrorism Conference Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism* (2017)

Ougaard, M. and Higgott, R., ed., *Routledge Studies in Globalization, Towards a Global Polity: Future trends and prospects* (2002)

RAN *Communication and Narratives (C&N)* and *RAN Deradicalisation and Desocialisation (EXIT), Dos and Don'ts of Involving Formers in PVE/CVE Work* (2017)

RUSI and the Prevention Project, *CVE Practitioner Workshop: Opportunities and Challenges for Civil Society in Pushing Back against Violent Extremism* (2016)

Schanzer, D., Kurzman, C., Toliver, J. and Miller, E., National Criminal Justice Reference Service(NCJRS), *The Challenge and Promise of Using Community Policing Strategies to Prevent Violent Extremism: A call for community partnerships with law enforcement to enhance public safety, Final Report* (2016)

Scholte, J.A., *Global Civil Society: Changing the world?* (1999)

Shtuni, A., United States Institute of Peace (USIP), *Dynamics of Radicalization and Violent Extremism in Kosovo* (2016)



The German Marshall Fund of the United States, Supporting Civil Society in Eastern Europe and the Western Balkans (2018)

The Prevention Project, Communities First: A blueprint for Organizing and Sustaining a Global Movement against Violent Extremism (2016)

The Prevention Project, Ensuring an Inclusive Approach to the Development and Implementation of National P/CVE Action Plans: The role of civil society (2017)

United Nations Development Programme (UNDP) and International Alert, Improving the Impact of Preventing Violent Extremism Programming: A toolkit for Design, Monitoring and Evaluation (March 2018)

United Nations Development Programme (UNDP), Public Pulse Analysis Perceptions of Civil Society in Kosovo (2016)

United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO), Preventing Violent Extremism through Education: A guide for policy-makers (2017)

United Nations General Assembly Seventieth Session, Plan of Action to Prevent Violent Extremism: Report of the Secretary-General (A/A/70/674)

United Nations, United Nations Security Council Resolution 1325 (2000) (2000, S/RES/1325)

United Nations, United Nations Security Council Resolution 2242 (2015) (2015, S/RES/2242)

United States Agency for International Development (USAID), President's Emergency Plan for Aids Relief (PEPFAR) and YouthPower, Promising Practices in Engaging Youth in Peace and Security and P/CVE (2017)

United States Agency for International Development (USAID), 2016 Civil Society Organization Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Eurasia (2017)

U.S. Department of State and United States Agency for International Development (USAID), Joint Strategy on Countering Violent Extremism (2016)

United States Institute of Peace (USIP), Measuring Up: Evaluating the impact of P/CVE Programs (August 2018)

United States Institute of Peace (USIP), Taking Stock: Analytic tools for understanding and designing P/CVE Programs (August 2018)

World Economic Forum, Digital Wildfires in a Hyperconnected World (2013)





**Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evrope**

Wallnerstrasse 6  
A-1010 Vienna, Austria  
Tel.: +43 1 514 360

pm@osce.org  
www.osce.org

**Ndiqni OSBE-në në:**



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë